


# REPORTI MONITORUES DHE VLERESUES



Korrik 2012 - Korrik 2013



## LIGJSHMËRIA, TRANSPARENCA DHE PJESËMARRJA E PUBLIKUT NË VENDIMARRJEN E KËSHILLIT BASHKIAK, DURRËS



## RAPORTI MONITORUES

# LIGJSHMËRIA, TRANSPARENCA DHE PJESEN MARRJA E PUBLIKUT NË VENDIMARRJEN E KËSHILLIT BASHKIAK DURRËS

PERIUDHA E MONITORIMIT:

KORRIK 2012- KORRIK 2013

(12 MUAJ)

Një botim i Qendrës për Çështje të Informimit Publik, INFOÇIP



Website: [www.infocip.org](http://www.infocip.org)  
e-mail: qendra@infocip.org

© copyright 2013 - Qendra për Çështje të Informimit Publik, INFOÇIP

#### Drejtori i Projektit

Gerti Shella,

#### Koordinator i Projektit

Gejsi Ndoja.

#### Team Members

Endrit Shabani  
Namik Musaku  
Erjon Sopi

#### Autor i metodës monitoruese & vlerësimit ligjor (PROAKTIV)

Gerti Shella, ekspert për aksesin në legjislacion

#### Website & Database administrator

Driton Selmani  
Ermir Tafa

#### Design & Faqosja:

Altin Aliaj

\* \* \*

#### Në kuadër te projektit:

"Fostering transparency in decision making process in local government by supporting active citizens' participation and through continuous civic monitoring."

**Mbështetur nga:**  
**National Endowment for Democracy, NED (Washington D.C.)**



National Endowment  
for Democracy  
Supporting freedom around the world

Mendimet dhe konsideratat e shprehura në këtë publikim janë të autorëve dhe nuk përfaqësojnë domosdoshmërisht ato të organizatës mbështetëse / donatorit.

# Përbajte

## HYRJE ..... 7

## PJESA E PARË

KUADRI LIGJOR DHE LEGJITIMITETI I MONITORIMIT .....	11
Qëllimi i Monitorimit .....	11
Vendimarrja në nivel vendor .....	12
Pjesëmarrja në procesin vendimarrës .....	13
Aksesi në legjislacionin vendor .....	14
Afatet ligjore të funksionimit të këshillave bashkiakë .....	15

## PJESA E DYTË

GJETJET E MONITORIMIT .....	19
ZBATUESHMËRIA E NENIT 33 .....	19
ZBATUESHMËRIA E NENIT 34 .....	22
ZBATUESHMËRIA E NENIT 35 .....	24
ZBATUESHMËRIA E AFATEVE FUNKSIONALE .....	28

## PJESA E TRETË

PERMBLEDHJE E KONKLUZIONEVE TE MONITORIMIT .....	33
--------------------------------------------------	----

## PJESA E KATËRT

REKOMANDIME .....	39
METODOLOGJIA .....	42

## FALENDERIME

*Qendra për Çështje të Informimit Publik, INFOÇIP, falenderon National Endowment for Democracy, NED, me seli në Washington D.C. përmbeshtetjen që i siguroi kësaj nisme për të dytin vit rradhazi.*

*INFOÇIP falenderon gjithashtu Këshillin Bashkiak Durrës për ndërveprimin e ofruar në kuadër të nismës.*

*Falenderimet e fundit, por jo për nga rëndësia, janë për stafin e INFOÇIP dhe anëtarët e Rrjetit të Transprencës Qytetare në Durrës.*

# HYRJE

## **“Transparenca dhe Pjesëmarrja e Publikut në Vendimarrjen e Këshillit Bashkiak Durrës”**

është një raport monitorues i cili hartohet dhe publikohet nga Qendra për Çështje të Informimit Publik, INFOÇIP për të dytin vit rradhazi. Nisma u realizua edhe këtë vit falë mbështetjes së rëndësishme të ofruar nga National Endowment for Democracy (NED), me seli ne Washington D.C.

Monitorimi mat dhe vlerëson përputhshëmërینë e aktivitetit dhe funksionimit të Këshillit Bashkiak Durrës me përcaktimet e ligjit 8652 “Per Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore”, i ndryshuar, sidomos të neneve të grupuara në KREUN VI të ligjit në fjalë.

Objekt parësor monitorimi dhe vlerësimi është zbatimi i neneve 33, 34 dhe 35 të ligjit 8652 nga Këshilli Bashkiak Durrës. Këto nene caktojnë modalitetet e diskutimit paraprak (me publikun) te projekt-vendimeve, votimit të tyre, si dhe të shpalljes dhe hyrjes në fuqi të vendimeve të miratuara. Zbatimi rigoroz i dispozitave që përbajnjë këto tre nene është kusht juridik dhe faktik për të garantuar vendimarrje transparente, pjesëmarrje të publikut dhe akses në legjislacionin vendor (njojte efektive me aktet e këshillit).

Objekt dytësor matjeje dhe vlerësimi në monitorimin e këtij viti janë afatet ligjore që normojnë aktivitetin e Këshillit Bashkiak (KREU VI, ligji 8652). Kapërcimi i këtyre afateve funksionale mund të çojë deri në vet-shkrirjen e Këshillit Bashkiak.

Periudha që mbulan monitorimi zgjat 12 muaj, respektivisht Korrik 2012-Korrik 2013. Arsyja që kjo periudhë nuk mbulan një vit standard kalendarik (1 Janar - 31 Dhjetor) por është e shpëndarë në dy vite ka të bëjë me konstituimin me vonesë të Këshillit të ri Bashkiak, Durrës pas përfundimit të Zgjedhjeve Vendore të 8 Majit, 2011. Ky konstituim u bë vetëm në muajin Gusht, 2011. Ndërkohë, 12 muajt e parë të mandatit 2011-2015 të Këshillit të ri Bashkiak u përmbyllën pikërisht me mbledhjen e datës 6 Korrik, 2012. Vendimet qarkulluese të kaluara në datë 26 Korrik 2012 nga ky Këshill, përcaktojnë edhe hapjen e periudhës së dytë monitoruese, 2012-2013 (follow up project).

Për të realizuar këtë monitorim, INFOÇIP dizenvoji qysh në fillim një mjet metodologjik të posaçëm,

të emërtuar **PROAKTIV**, që përfaqëson një ndër prurjet më të rëndësishme të kësaj nisme. **PROAKTIV** (akronim i modifikuar për: *Protokoll i Vlerësimit të Transparencës Vendimarrëse në Këshillin Bashkiak përmes Pjesëmarrjes Aktive*) është *sui-generis*, që do të thotë se është konceptuar apo “*qepur pas trupit*” të legjislacionit përkatës në fuqi në Republikën e Shqipërisë, në rastin konkret **ligji 8652 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore”, i ndryshuar**.

Në fokus të monitorimit është ekskluzivisht veprimtaria e Këshillit Bashkiak, i cili ushtron funksionet e organit kolegjial vendimarrës në nivel vendor. Administrata e Bashkisë, si një organ i centralizuar monokratik, që drejtohet nga kryetari i bashkisë, nuk është objekt monitorimi. Kjo përqasje diferençuese përfaqëson një tjetër risi, nëse mbahet parasysh se deri më sot nuk i është kushtuar kujdes ndarjes dhe veçimit të funksioneve vendimarrëse dhe atyre ekzekutive në nivel vendor.

Në vitin e parë të monitorimit, INFOÇIP përllogariti edhe nivelin e zbatueshmërisë nga vetë Këshilli Bashkiak, Durrës të dispozitave që përbajnjë nënet 33, 34 dhe 35 të ligjit 8652. Në monitorimin e dytë, që përban ky publikim, ky vlerësim specifik nuk u aplikua, për shkak të aktivitetit mjaft të reduktuar që Këshilli Bashkiak Durrës zhvilloi; vetëm 3 mbledhje gjithsej në 12 muaj.

Gjetjet e këtij monitorimi kanë target specifik Pushtetin Vendor Durrës, pa përjashtuar Pushtetin Qendror i cila ka detyrimin ligjor mbikqyerjen e këtij të fundit. Një target tjetër specifik janë donatorët (qeveritarë ose jo-qeveritarë) të cilët punojnë me qeverisjen vendore dhe komunitetin. Një tjetër target i synuar janë mediat, lokale dhe kombëtare, të cilat tregojnë një interesim të vazhdueshëm lidhur me proceset vendimarrëse në qytetin e Durrësit. Po ashtu, ky Raport i vihet në dispozicion edhe të gjithë qytetarëve durrsakë, të cilët, përmë tepër, kanë dhënë një kontribut direkt në këtë proces monitorimi.

**GERTI SHELLA**  
**DREJTOR EKZEKUTIV**  
**Qendra për Çështjet e Informimit Publik**



# PJESA E PARE

## KUADRI LIGJOR & LEGJITIMITETI I MONITORIMIT



# 1

# KUADRI LIGJOR & LEGJITIMITETI I MONITORIMIT

## I. ÇFARË SYNON MONITORIMI

### VLERËSIMI I AKTIVITETIT VENDIMARRES

**Ligji 8652, datë 31.7.2000** “Për Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore”, i ndryshuar, ka të transpozuara me kujdes disa parime të rëndësishme kushtetuese, me synimin e qartë për të garantuar një proces vendimarës të hapur ndaj publikut. Siç edhe do të shpjegohet më poshtë, ligjvënesi ka lidhur organikisht në dispozitat e këtij ligji procedurën vendimarrëse të këshillave me të drejtën e publikut për të qenë i përfshirë në këtë vendimarrje. Kjo përfshirje aktivizohet **në fillim, gjatë** dhe **në fund** të procesit vendimarrës. Konkretnisht ajo konsiston në shqyrtimin paraprak të një kategorie aktesh me palët e interesuar, ndjekjen e mbledhjeve në sallë dhe aksesin në vendimet e materializuara të Këshillit. Kjo e fundit garantohet si përmes shpalljes së akteve nga vetë Këshilli bashkiak/komunal (proactive disclosure) ashtu edhe informimit aktiv (përmes referimit direkt në dispozitat e ligjit 8503 “Për të drejtën e informimit për dokumentat zyrtare”).

Nenet 34 dhe 35 të ligjit 8652 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore”, i ndryshuar, janë misërimi praktik i kësaj lidhjeje organike që synon garantismin e një procesi vendimarës transparent dhe të hapur ndaj publikut. Kurse nenit 33 normon në tërësi procedurën e votimit dhe mënyrën e hyrjes në fuqi (pika 6) të vendimeve të Këshillit. Zbatimi rigoroz i këtyre tre neneve është kusht juridik për të patur një vendimarrje të bazuar në ligj dhe të hapur ndaj publikut.

Matja apo vlerësimi i nivelit të implementimit të neneve 34 dhe 35 prodhon automatikisht indikatorë të drejpërdrejtë për vlerësimin objektiv të përfshirjes së publikut në vendimarrjen lokale dhe transparencës së kësaj të fundit. Kurse matja e implementimit të nenit 33, indikon ligjshmërinë e akteve dhe fuqinë e tyre juridike. Çdo monitorim për vlerësimin e transparancës dhe përfshirjes në vendimarrjen lokale jashtë kësaj llogjike do të ishte një përqasje jo-motodike, jo-serioze, e paaftë për të “diagnostikuar” problemet në vendimarrjen lokale.

### VLERËSIMI I AFATEVE FUNKSIONALE

**Ligji 8652, datë 31.7.2000** “Për Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore”, i ndryshuar, rregullon me kujdes aktivitetin e këshil-lave bashkiakë përmes caktimit të afateve funksionale. Aplikimi i këtyre afateve fillon që në momentin e konstituimit të këshillave dhe vazhdon përgjatë gjithë kohës së ushtrimit të aktivitetit të tyre vendimarrës.

Ndër afatet më të rëndësishme që mat dhe vlerëson ky monitorim, janë periodiciteti i zhvillimit të mbledhjeve dhe miratimi i buxhetit vjetor. Mos-respektimi i këtyre afateve mund të çojë deri në shkrirjen e keshillave bashkiakë. Një parashikim të tillë ekstem, ligji **8652** e shpreh qartësisht, madje duke e përsëritur dy herë, konkretisht në nenit 31, pika 8 (*Funksioni i këshillit*) dhe në nenin 38, “*Shpërndarja e parakohshme e këshillit*”.

### Metoda monitoruese

Zhvillimi i një metode për matjen e nivelit të zbatimit të këtyre tre neneve dhe implementimi në praktikë i saj ishte një ndër objektivat kryesorë të këtij projekti. Mjeti kryesor metodologjik i zhvilluar nga INFOÇIP dy vjet më parë u emërtuar **PROAKTIV** (akronim i modifikuar për: *Protokoll i Vlerësimit te Transparencës Vendimarrëse në Keshillin Bashkiak përmes Pjesëmarrjes Aktive*). Ky është një protokoll *sui-generis*, i “*qepur pas trupit*” të ligjit 8652 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore”, i ndryshuar. Në vija të përgjithshme, qasja **PROAKTIV** ndërthur në një bllok të vetëm **monitorimin e ligjshmërisë së procesit vendimarrës të Këshillit Bashkiak** përmes **pjesëmarrjes** dhe **raportimit aktiv qytetar** (Model metodologjik i tipit “*Monitorim përmes Pjesëmarrjes*”, ose shkurt *MP*).

## II. VENDIMARRJA NË NIVEL VENDOR

Qeverisja vendore në Republikën e Shqipërisë ngrihet në bazë të parimit të decentralizmit të pushtetit dhe ushtrohet sipas parimit te autonomisë vendore (*Neni 13 i Kushtetutës*).

Organet e qeverisjes vendore kanë të drejtë të nxjerrin akte. Aktet që nxirren nga organet e pushtetit vendor kanë fuqi vetëm brenda juri-dikcionit territorial që ushtrojnë këto organe (*Neni 116 i Kushtetutës*). Parimet dhe procedurat për nxjerrjen e akteve juridike vendore parashikohen me ligj (*Neni 120 i Kushtetutës*).

Ligji 8652, datë 31.7.2000 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore”, i ndryshuar<sup>1</sup>, normon veprimtarinë institucionale të organeve të qeverisjes vendore në RSH. Sipas këtij ligji, organet e njësive të qeverisjes vendore ushtrojnë kompetencat e tyre nëpërmjet vendimeve, urdhëresave dhe urdhërave (*Neni 7, ligji 8652*). Këto lloj aktesh janë të detyrueshme për të gjitha subjektet e përfshira në akt, nën juridikcionin e tyre (*Neni 8, pika “b”, ligji 8652*).

Funksioni kryesor vendimarrës në nivel vendor realizohet nga këshillat bashkiakë/komunale. Këta të fundit konsiderohen si parlamentet e qyteteve dhe ligji iu ngarkon kompetenca shumë të rëndësishme vendimarrëse, të tilla si caktimi i taksave dhe tarifave vendore, miratimin e buxhetit vjetor, kredi-marrje dhe grant-marrje në vlera të konsiderueshme, apo edhe vendimarje mjaft kritike mbi territorin dhe pronat që i kanë kaluar tashmë në administrim pushtetit vendor.

Në ushtrim të kompetencave të tyre, këshillat bashkiakë/komunalë nxjerrin vendime me karakter normativ dhe individual, të detyrueshme për t'u zbatuar nga subjektit nën juridikcionin e tyre. Ligji 8652, datë 31.7.2000 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore”, i ndryshuar, normon me hollësi procesin e shqyrtimit, votimit dhe shpalljes së vendimeve të këshillave bashkiakë/ komunalë (*neni 33 i ligjit 8652*).

Votimi në këshill bëhet i hapur ose i fshehtë. Këshilli vendos përrastet kur votimi bëhet i fshehtë. Aktet me karakter individual miratohen kur doherë me votim të fshehtë.

Pas ndryshimeve që pësoi *ligji 8652* në vitin 2004, parashikohet vetëm një rast kur vendimet duhet të merren me tre të pestat të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të Këshillit, dhe kjo është konkretist në rastin kur Këshilli “miraton tjetësimin ose dhënien në përdorim të pronave të tretëve”.

### SIPAS NENIT 32 TË LIGJIT 8652, KËSHILLI BASHKIAK KA KOMPETENCAT E MËPOSHTME:

- a) Miraton statutin e komunës ose të bashkisë, si dhe rregulloren e brendshme të funksionimit të vet.
- b) Zgjedh dhe shkarkon kryetarin dhe zëvendëskryetarin e këshillit.
- c) Emëron dhe shkarkon sekretarin e këshillit komunal ose bashkiak.
- d) Miraton strukturën organizative dhe rregulloret bazë të administratës së komunës ose të bashkisë, të njësive e institucioneve buxhetore në varësi të komunës ose të bashkisë, si dhe numrin e personelit të tyre, kërkesat për kualifikimin, pagat dhe mënyrat e shpërbimit të punonjësve dhe të personave të tjera të zgjedhur ose të emëruar në përputhje me legjislacionin në fuqi.
- e) Miraton aktet e themelimit të ndërmarrjeve, shoqërive tregtare, si dhe të personave të tjera juridikë që krijon vetë ose është bashkëthemelues.
- f) Miraton buxhetin dhe ndryshimet e tij.
- g) Miraton tjetësimin ose dhënien në përdorim të pronave të tretëve.
- h) Organizon dhe mbikëqyr kontrollin e brendshëm të komunës ose bashkisë.
- i) Vendos përtaksat e tarifat vendore, si dhe nivelin e tyre.
- j) Vendos përmarrjen e kredive dhe shlyerjen e detyrimeve ndaj të tretëve.
- k) Vendos përkrijimin e institucioneve të përbashkëta me njësi të tjera të qeverisjes vendore, përfshi subjektin e kompetencave të përbashkëta ose me persona të tretë.
- l) Vendos përfillimin e procedurave gjyqësore përsëhtje të kompetencës së vet.
- m) Zgjedh përfaqësuesit e këshillit komunal ose bashkiak në këshillin e qarkut.
- n) Vendos përdorimin ose heqjen e mandatit të këshilltarit.
- o) Miraton norma, standarde e kriterë përrregullimin dhe disiplinimin e funksioneve që i janë dhënë atij me ligj, si dhe përmbrojtjen dhe garantimin e interesit publik.
- p) Vendos përsimbiolet e komunës ose të bashkisë.
- q) Vendos përemërtimin e rrugëve, të shesheve, të territoreve, të institucioneve dhe të objekteve në juridikcionin e komunës ose të bashkisë.
- r) Jep tituj nderi dhe stimuj.
- s) Vendos përrregullat, procedurat dhe mënyrat e realizimit të funksioneve të deleguara, në bazë dhe përzbatim të ligjit me të cilin bëhet ky delegim te komuna ose bashkia.

### III. PJESEMARRJA NË PROCESIN VENDIMARËS

Pushteti vendor në Republikën e Shqipërisë ka përmision kryesor sigurimin e qeverisjes në nivel sa më afër shtetasve nëpërmjet "respektimit të të drejtave dhe lirive themelore të shtetasve të sanksionuara në Kushtetutë ose në ligje të tjera" (Neni 3, ligji 8652).

E drejta e pjesëmarrjes dhe informimit përfshihen në kreun "Të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut", në Kushtetutën e Shqipërisë. Neni 23 i saj përcakton shprehimisht se:

- 1) E drejta e informimit është e garantuar.
- 2) Kushdo ka të drejtë, në përputhje me ligjin, të marrë informacion për veprimtarinë e organeve shtetërore, si dhe të personave që ushtronjnë funksione shtetërore.
- 3) Kujtdo i jepet mundësia të ndjekë mbledhjet e organeve të zgjedhura kolektive.

Këto garanci kushtetuese janë transpozuar me besnikëri në dispozitat e **ligjit 8652**, "Për Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore", i ndryshuar. Lidhur me të drejtën e pjesëmarrjes së publikut, **neni 34** i këtij ligji përcakton shprehimisht se: *Mbledhjet e këshillit janë të hapura për publikun. Çdo qytetar lejohet të ndjekë mbledhjet e këshillit, sipas mënyrës së përcaktuar në rregulloren e këshillit (Paragrafi 1, nen 34).*

Këshilli komunal ose bashkiak, përpara shqyrtimit dhe miratimit të akteve, zhvillon seanca këshillimi me bashkësinë. Këshillimi me bashkësinë, në çdo rast, bëhet sipas mënyrës së përcaktuar në rregulloren e këshillit, duke përdorur një nga format e nevojshme si takimet e hapura me banorët, takime me specialistë, me institucione të interesuara dhe organizata joqeveritare ose nëpërmjet marrjes së nismës për organizimin e referendumeve vendore (*neni 35, paragrafi 2*).

*Pjesëmarrja e publikut në vendimarrje* nuk është e njëjtë gjë me **aksesin e publikut ne legjispcionin vendor**. E para implikon ekskluzivisht pjesëmarrjen e aktorëve të interesuar dhe pubikut të gjerë gjatë procesit të draftimit apo shqyrtimit të projekt-akteve, me synim harmonizimin sa më të gjere të vendimarrjes, kurse e dyta implikon në shumicën e rasteve aksesin në legjispcionin vendor, ose e thënë ndryshe, njojhen efektive të publikut me vendimet e nxjerra nga Këshilli. Pjesëmarrja ndodh përpara dhe gjatë votimit të akteve, kurse e dyta

pasi procesi i shqyrtimit dhe votimit të tyre ka përfunduar. Ligjvënesi ka treguar kujdes që pjesëmarrja e publikut në vendimarrje dhe garanatimi i aksesit të publikut në vendimet e marra përmes shpalljes së tyre të janë të normuara veç e veç.

#### NENI 33

##### "VOTIMI"

1. Votimi në këshill bëhet i hapur ose i fshehtë. Këshilli vendos përrastet kur votimi bëhet i fshehtë. Aktet me karakter individual miratohen kur doherë me votim të fshehtë.
2. Vendimet e këshillit merren me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm në mbledhje.
3. Vendimet, përrastet e parashikuara ne shkronjat "b", "c", "d", "dh", "f", "g", "gj", "i" dhe "j" te nenit 32 te këtij ligji, merren me shumicën e votave te numrit te përgjithshëm te anëtarëve te këshillit.
4. Vendimet merren me tre të pestat të numrit te përgjithshëm të anëtarëve të këshillit përrastet e parashikuara në nenin 32 shkronja "e" e këtij ligji.
5. Në rastet e votimit për kryetarin, zëvendëskryetarin dhe sekretarin e këshillit, kur nuk sigurohet shumica e kërkuar, votimi ribëhet midis dy kandidatëve, që në raundin e parë kanë fituar numrin më të madh të votave.
6. Aktet e këshillit shpalen brenda 10 ditëve nga data e miratimit të tyre dhe hyjnë në fuqi 10 ditë pas shpalljes. Aktet me karakter individual hyjnë në fuqi në datën e njoftimit të tyre subjekteve që përfshihen në to.

#### NENI 34

##### "MBLEDHJET E HAPURA"

1. Mbledhjet e këshillit janë të hapura për publikun. Çdo qytetar lejohet të ndjekë mbledhjet e këshillit, sipas mënyrës së përcaktuar në rregulloren e këshillit.
2. Njoftimi për mbledhjen e këshillit bëhet publik në vende të caktuara nga këshilli dhe në media. Njoftimi përmban datën, vendin, orën dhe rendin e ditës së mbledhjes.
3. Këshilli, me shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve, vendos përrastet kur mbledhja bëhet e myllur.

## IV. AKSESI NË LEGJISLACIONIN VENDOR

**Lidhur me shpalljen dhe hyrjen në fuqi të vendimeve** të këshillave bashkiakë / komunalë, nen 33/6 përcakton se "Aktet e këshillit shpalen brenda 10 ditëve nga data e miratimit të tyre dhe hyjnë në fuqi 10 ditë pas shpalljes. Aktet me karakter individual hyjnë në fuqi në datën e njostimit të këtyre subjekteve që përfshihen në to."

Aktet e Këshillit afishohen, në vende publike të caktuara nga ky i fundit, brenda territorit të komunës ose bashkisë dhe, sipas mundësive, këshilli cakton edhe forma të tjera të publikimit të tyre. Informimi i publikut në çdo komunë e bashki bëhet në përputhje me ligjin nr.8503, datë 30.6.1999 „Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare“ dhe rregullat e përcaktuara nga vetë këshilli përkatës për këtë qëllim (neni 35 i ligjit 8652). Në këtë pikë, modalitetet juridike të vendimarrjes dhe ato të transparencës me publikun janë praktikisht të shkrira organikisht tek njëra tjetra (ose zgjatime të njëra tjetres).

Zbatimi i këtyre dispozitave është kusht **juridik** dhe **faktik** për të garantuar aksesin e publikut

### NENI 35

#### SEANCAT E KËSHILLIMEVE ME BASHKËSİNË DHE E DREJTA E PUBLIKUT PËR T'U INFORMUAR

1. Këshilli komunal ose bashkiak, përparrashyrtimit dhe miratimit të akteve, zhvillon seanca këshillimi me bashkësinë. Seancat e këshillimit janë të detyrueshme përrastet e parashikuara në nenin 32 shkrnjat "dh", "e", "f" dhe "k" të këtij ligji.
2. Këshillimi me bashkësinë, në çdo rast, bëhet sipas mënyrës së përcaktuar në rregulloren e këshillit, duke përdorur një nga format e nevojshme si takimet e hapura me banorët, takime me specialistë, me institucione të interesuara dhe organizata joqeveritare ose nëpërmjet marrjes së nismës për organizimin e referendumeve vendore.
  - 2/1. Për këshillat komunale/bashkiake janë te detyrueshme seancat e këshillimit me kryetaret dhe kryesine e fshatrave nen juridikson, ne përputhje me përcaktimet e bëra ne shkrnjat "ç", "dh", "e", "f", "k" dhe "ll" te nenit 32 te ligjit. Seancat e këshillimit, ne këtë rast, shënohen ne procesverbal.
3. Aktet e këshillit afishohen, në vende publike të caktuara nga këshilli, brenda territorit të komunës ose bashkisë dhe, sipas mundësive, këshilli cakton edhe forma të tjera të publikimit të tyre. Informimi i publikut në çdo komunë e bashki bëhet në përputhje me ligjin nr.8503, datë 30.6.1999 "Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare" dhe rregullat e përcaktuara nga vetë këshilli përkatës për këtë qëllim

në legjislacionin lokal, në kuptimin e njohjes efektive të tij me aktet që miraton Këshilli Bashkiak. Edhe njëherë ritheksojmë se aksesi i publikut në vendimarrjen e materializuar të Këshillit (vendimet dhe johja e tyre prej paleve ato adresojnë) nuk është i njëjtë në esencë me pjesëmarrjen e publikut në shqyrimit paraprak të projekt-akteve të Këshillit. E para nënkupton pasjen/garantimin e mundësive efektive të njohjes me normat juridiko-administrative që cakton Këshilli Bashkiak kurse dyta ka të bëjë direkt me atë që quhet "Vendimarrje me pjesëmarrje".

Konsultimet e Kshëshillit me palët e interesit hapin procesin vendimarrës, kurse konkretizimi i vendimeve në letër është sinteza apo produkti final i procesi vendimarrës. Edhe pse publikut mund t'i jetë garantuar pjesëmarrja (fizike) në procesin vendimarrës, në rastin kur atij nuk i garantohen mundësi efektive të njohjes me aktet ku materializohet ky proces, pra vetë pjesëmarrja, e humbet qëllimin.

Publikimi i akteve zyrtare përbën një nga parimet themelore të qeverisjes, si në nivel qendror ashtu edhe vendor. Ky parim asfirmon kushtin që subjektet fizike dhe juridike të mund të njohin normat ligjore që nxjerrin organet qeverisëse në mënyrë që të kenë mundësi më pas t'i zbatojnë ato. Për këtë arsy, ky është një shërbim publik, të cilin këto organe duhet ta ofrojnë në çmimin e kostos. Në ligjerimin teorik, kjo referohet edhe si "informim proaktiv (eng: proactive disclosure)", për ta dalluar atë nga "informimi aktiv" i cili aktivizohet nga vetë subjekti (qytetari) bazuar në të drejtën e tij për informim. Ligji 8682, "Për Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore", i ndryshuar, ka të parashikuar edhe këtë format informimi (atë aktiv) mbi aktet e që nxjerrin autoritet vendore, duke bërë referencë direkte në ligjin nr.8503, datë 30.6.1999 „Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare“. E njëjtë dispozitë ligjore që përcakton detyrimin dhe modalitet e shpalljes dhe publikimit të akteve të Këshillit, përcakton shprehimisht edhe se: "Informimi i publikut në çdo komunë e bashki bëhet në përputhje me ligjin nr.8503, datë 30.6.1999 "Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare" dhe rregullat e përcaktuara nga vetë këshilli përkatës për këtë qëllim"(neni 35, pika 3, fjalia e dyte).

## V. AFATET LIGJORE TE FUNKSIONIMIT TE KESHILLIT BASHKIAK

Ligi 8652, datë 31.7.2000 "Për Organizimin e Funksionimit e Qeverisjes Vendore", i ndryshuar, irregullon me kujdes aktivitetin e këshillave bashkiakë përmes caktimit të afateve funksionale. Edhe pse ligji vetë nuk është i pajisur me një kapitull të posaçëm sanksionesh, ligjvënëse është kujdesur që këto të fundit të aktivizohen përgjithësisht në rastet kur afatet ligjore të përcaktuara (brenda të cilave Këshilli performon funksionet e tij vendimarrëse) shkelen ose tejkalojen.

Aplikimi i afateve ligjore fillon që në momentin e konstituimit të këshillave dhe vazhdon përgjatë gjithë kohës së ushtrimit të mandatit. Këshilli duhet të zhvillojë mbledhjen e parë jo më vonë se 20 ditë nga shpallja e rezultatit të zgjedhjes nga KQZ (*neni 26, pika 1*). Në rast se as sekretari i Këshillit Bashkiak as Prefekti nuk e ushtrojnë këtë të drejtë brenda afatit të parashikuar në pikën 1 të këtij nenit, atëherë këshilli mblidhet vetë brenda 10 ditëve (*neni 26/3*).

Neni 31 "Funksionimi i këshillit komunal ose bashkiak" bën përcaktimë të rëndësishme sa i takon afateve funksionale të këshillit. Kështu, mbledhjet e radhës të këshillit duhet të zhvillohen si jo më pak se një herë në muaj (*neni 34 pika 2*). Thirrja për mbledhjen e këshillit bëhet nga kryetari i këshillit dhe njoftimi për mbledhjen bëhet, si irregull, jo më pak se 5 ditë para datës së zhvillimit të saj (*neni 34, pika 4*). Kur këshilli nuk mblidhet për shkak të mungesës së anëtarëve të tij gjatë tre muajve, duke filluar nga data e mbledhjes së fundit të tij, këshilli quhet i vetëshpërndarë. Vetëshpërndarja pasohet me zgjedhje të reja për këshillin përkatës dhe sekretari i këshillit komunal ose bashkiak, brenda 10 ditëve nga përfundimi i afatit 3-mujor, njofton prefektin (*neni 31, pika 8*).

Ligi 8652 ka gjithashtu dhe një nen të posaçëm "Për shpërndarjen e parakohshme të Këshillit". Ky është nen 38, i cili parashikon qartë tre raste kur këshilli shpërndahet para kohe, konkretisht: **1)** kur nuk mblidhet pëtre muaj rrjesht, **2)** kur nuk miraton buxhet, dhe **3)** kur bën shkelje të rënda të ligjit dhe Kushtetutës.

Sic shihet, vet-shpërndarja e Këshillit, nëse qëndron tre muaj pa aktivitet, është e parashikuar dy herë në dy nene të ndryshme (*neni 31, pika 8 dhe nen 38, pika 1*).

Po ashtu, edhe mos-miratimi i buxhetit vjetor, nga Këshilli brenda 3 muajve nga data e caktuar në nenin 19 të ligjit, është gjithashtu motiv për shkrirjen e këshillit. Në përgjithësi, në praktikën administrative shqiptare, periudha standart për kalimin e buxhetit konsiderohen

### NENI 31

#### FUNKSIONIMI I KESHILLIT BASHKIAK.

8. Kur këshilli nuk mblidhet për shkak të mungesës së anëtarëve të tij gjatë tre muajve, duke filluar nga data e mbledhjes së fundit të tij, këshilli quhet i vetëshpërndarë. Vetëshpërndarja pasohet me zgjedhje të reja për këshillin përkatës dhe sekretari i këshillit komunal ose bashkiak, brenda 10 ditëve nga përfundimi i afatit 3-mujor, njofton prefektin

### NENI 38

#### SHPËRNDARJA E PARAKOHSHME E KESHILLIT KOMUNAL OSE BASHKIAK

1. Këshilli komunal ose bashkiak shpërndahet para kohe me vendim të Këshillit të Ministrave kur:
  - a) nuk mblidhet për një periudhë të vazhdueshme tremujore;
  - b) nuk arrin të marrë vendim përmiratimin e buxhetit brenda tre muajve nga data e përcaktuar në nenin 19 të këtij ligji;
  - c) kryen shkelje të rënda të Kushtetutës ose ligjeve.
2. Këshilli komunal ose bashkiak shpërndahet edhe kur bëhet riorganizim me ndryshim kufijsh, sipas nenit 70 të këtij ligji.
3. Në rast të lënies në fuqi të vendimit të shpërndarjes nga organi kompetent, në komunën ose bashkinë përkatëse organizohen zgjedhjet për këshillin, në përputhje me Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë.

muajt nëntor-dhjetor, pra një apo dy muaj para ardhjes së vitit të ri fiskal mbi të cilin buxheti aplikohet. Shtyrja përtej këtij afati mund "të durojë" deri në muajin mars, maksimumi prill. Miratimi i buxhetit vjetor në 6-mujorin e dytë të vitit, pra nga korriku e tutje, është në fakt një abuzim administrativ dhe pa vlerë nga pikpamja e gjenerimit të efekteve të synuara buxhetore.

Së fundmi, afatet aplikohen jo vetëm mbi këshillin si një entitet vendimarrës, por edhe mbi anëtarin e këshillit (këshilltarin), si subjekt individual. Në rast se ky i fundit nuk merr pjesë në mbledhjet e këshillit për një periudhë 6-mujore, mandati i imbaron përparrë afatit (*neni 27, pika 4, gjëma "e"*).

### NENI 19

#### BUXHETI I NJËSIVE TË QEVERISJES VENDORE

4. Miratimi i buxhetit të ri dhe mbyllja e buxhetit të vitit të mëparshëm bëhet sipas afateve të përcaktuara në ligjin nr.8379, datë 29.7.1998 "Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë".
5. Buxheti i çdo njësie të qeverisjes vendore miratohet nga këshilli përkatës. Miratimi i buxhetit dhe i bilancit të tij mbyllës, bëhen në afatet e përcaktuara në ligjin nr. 8379, datë 29.7.1998 "Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë".



# **PJESA E DYTE**

**PARAQITJE E DETAJUAR  
E GJETJEVE TE MONITORIMIT**



# 2

## GJETJET E MONITORIMIT

### 1. ZBATUESHMËRIA E NENIT 33 "VOTIMI"

**Ligji 8652 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore", i ndryshuar.**

#### NENI 33 "VOTIMI"

1. Votimi në këshill bëhet i hapur ose i fshehtë. Këshilli vendos për rastet kur votimi bëhet i fshehtë. Aktet me karakter individual miratohen kur doherë me votim të fshehtë.
2. Vendimet e këshillit merren me shumicën e votave të anëtarëve të pronishëm në mbledhje.
3. Vendimet, për rastet e parashikuara ne shkronjat "b", "c", "d", "dh", "f", "g", "gj", "l" dhe "j" te nenit 32 te këtij ligji, merren me shumicën e votave te numrit te përgjithshëm te anëtarëve te këshillit.
4. Vendimet merren me tre të pestat të numrit të përgjithshëm të anëtarëve të këshillit për rastet e parashikuara në nenin 32 shkronja "e" e këtij ligji.
5. Në rastet e votimit për kryetarin, zëvendëskryetarin dhe sekretarin e këshillit, kur nuk sigurohet shumica e kërkuar, votimi ribëhet midis dy kandidatëve, që në raundin e parë kanë fituar numrin më të madh të votave(2).
6. Aktet e këshillit shpallen brenda 10 ditëve nga data e miratimit të tyre dhe hyjnë në fuqi 10 ditë pas shpalljes. Aktet me karakter individual hyjnë në fuqi në datën e njofitimit të tyre subjekteve që përfshihen në to.

#### GJETJET E MONITORIMIT

### 1.1 VOTIMI I FSHEHTE I VENDIMEVE ME KARAKTER INDIVIDUAL (NENI 33/1)

Gjatë 12-mujorit të dytë të ushtrimit të mandat-Këshilli Bashkiak i Durrësit ka miratuar gjithsej 70 vendime. Plot 38 prej tyre janë marrë në vitin 2012, kurse pjesa tjetër i takojnë vitit 2013.

Shumica e vendimeve (66) kanë karakter individual (66 gjithsej) dhe vetëm katër janë normative. Klasifikim i vendimeve në dy kategori, *individuale* dhe *normative*, është proces thelbësori analizës në kuadër të këtij Raporti pasi është kusht për të vlerësuar nivelin e zbatimit të *dispozitës 33/1* nga ana e Këshillit Bashkiak. Kjo dispozitë përcakton shprehimisht se "Aktet me karakter individual miratohen kur doherë me votim të fshehtë". Nga vlerësimi tërësor dhe i kujdesshëm i të gjitha materialeve filmike ku janë dokumentuar mbledhjet e Këshillit Bashkiak, rezulton se kjo dispozitë e ligjit nuk është

respektuar në asnjë rast. Për të gjitha vendimet me karakter individual këshilltarët bashkiakë kanë bërë votim të hapur. Anashkalimi i plotë i procedurës që përcakton neni 31 pika 1 përvotimin e fshehtë të vendimeve me karakter individual, në rastin e Durrësit nuk rezulton se diktohet nga infrastruktura e munguar në sallën ku zhvillohen mbledhjet e Këshillit Bashkiak. Kjo është një sallë moderne, e pajisur me infrastrukturë elektronike votimi.

Në rastin më të mirë, arsyaja duhet kërkuar tek mos-njohja e ligjit nga këshilltarët, një "mos-njohje" deri diku e justifikuar, po të mbahet parasysh se nuk ka asnjë manual apo rregullore që të interpretojë dhe/apo caktojë kriterë se çfarë dhe si dallohet një vendim individual nga një vendim normativ (*lexo më shumë tek Rekomandimet*).

#### Si dallohet akti normativ nga ai individual

Akti administrativ individual rregullon në veçanti marredhenie konkrete të posaçme për një çështje të caktuar dhe ndaj një subjekti ose grupi subjektesh te identifueshem. Edhe ne rastet kur akti administrativ i shtrin efektet e tij jo per një person te caktuar, por per një grup ose një kategori me te gjere subjektesh te verifikueshme dhe identifikueshme, karakteri i tij individual mbetet. Nese marredhenia juridike që ai rregullon eshtë konkrete, akti nuk e humbet individualitetin e tij.

Kur me anë te një akti vendoset rregulla te detyrueshme sjelljeje per një marredhenie juridike ose per një kompleks marrëdhënie, ai konsiderohet akt i përgjithshem ose normativ. Akti ne këtë rast eshte abstrakt. Ai rregullon marredhenie ne tërësi dhe per një kategori te gjere subjektesh. Akti i përgjithshem nuk i referohet një fakti konkret, por një numri faktesh te mundshme ose hipotetike. Akti normativ, per te qene i njejtë per te gjithe, formulohet ne kuptimin me te përgjithshem dhe abstrakt, duke i u referuar pa asnjë lloj diskriminimi cdonjerit dhe per çfarðo lloj fakti. Ne aktin normativ perfshihen ato norma që rregullojnë marredhenie te përgjithshme, ne dallim nga akti individual që perfshin norma që rregullojnë marredhenie per subjekte ose objekte.

## GJETJET E MONITORIMIT

### 1.2 VENDIME TË KËSHILLIT QË MERREN ME SHUMICË TË THJESHTË (NENI 33/2 & 33/3)

#### VENDIME NORMATIVE

Nga totali i VKB për periudhën e monitoruar, vetëm katër kanë karakter të pastër normativ. Më i rëndësishmi prej tyre është VKB nr. 123 "Për Miratimin e Projekt-Planit të përgjithshëm vendor të Bashkisë Durrës". **Në të katra rastet, votimi është bërë i hapur, dhe sa kohë që këto janë vendime normative, kjo konsiderohet një praktikë votimi konform përcaktimit ligjor.**

Vendimarrja për Paketën Fiskale 2013 (*taksat dhe tarifat vendore*) si dhe për Buxhetin 2013 (*pagat e administratës, investimet publike, etj*) nuk u realizua dot nga Këshilli Bashkiak Durrës, edhe pse këto dy vendimarrje normative janë ndër më themelore në veprimtarinë vjetore të Këshillit. Arsyet e këtij dështimi do të analizohen në kapitujt më poshtë.

#### MODALITETETE VOTIMIT

Neni 33/3, përcakton shprehimisht se *Vendimet, për rastet e parashikuara ne shkronjat "b", "c", "d", "dh", "f<sup>2</sup>", "g", "g<sup>2</sup>", "i" dhe "j" te nenit 32 te këtij ligji, merren me shumicën e votave të numrit te përgjithshëm te anëtarëve te këshillit.*

**Nga monitorimi në sallë i procesit vendimarës nga ana e Këshillit Bashkiak, Durrës, rezulton se kjo kërkesë e ligjit është respektuar** Ndërkohe, bazuar në të dhënët e raportuar nga anëtarët e ZTO, Durrës, por edhe nga vlerësimi në vend i bërë nga stafi i INFOÇIP i cili gjithashtu ka ndjekur rigorozisht mbledhjet e Këshillit bashkiak Durrës, rezulton se, në përgjithësi të gjitha vendimet janë marrë *me shumicën e votave të anëtarëve të pranishëm në mbledhje*. **Kjo e dhënë çon në perfundimin se pika 2 e nenit 33 të ligjit 8652 të ndryshuar është zbatuar rigorozisht gjatë vendimarrjes në sallën e mbledhjeve të Këshillit.**

## GJETJET E MONITORIMIT

### 1.3 VENDIME TË KËSHILLIT QË MERREN ME TRE TË PESTAT (NENI 33/4)

*Ligji 8652, i ndryshuar*, parashikon vetëm një rast vendimarrje për të cilën nevojiten 3/5 e votave të të gjithë anëtarëve të Këshillit, konkretisht "*për rastet e parashikuara në nenin 32 shkronja "e" e këtij ligji*", ose e thënë ndryshe, në rastet kur Këshilli miraton *tjetërsimin ose dhëni* *në përdorim të pronave të tretëve*.

Gjatë 12 muajve që mbuloi monitorimi, Këshilli Bashkiak, Durrës ka marrë të paktën 5 vendime për tjetërsimin ose dhëni në përdorim të pronave të tretëve. Në të gjitha këto raste votimi ka qenë pothuajse unanim dhe pika 4 e nenit 33 te ligjit 8652 është respektuar.

Sai takon vendimeve VKB-ve për tjetërsim ose dhënie në përdorim të pronës, duhet bërë një vlerësim i

tre-fishtë sa i takon respektimit të dispozitave ligjore të votimit. Kujtojmë këtu që këto vendime janë me natyrë të pastër individuale, pasi i referohet një fakti konkret dhe nëpërmjet këtyre akteve nuk vendosen norma të përgjithshme dhe abstrakte. Neni 33/1 përcakton shprehimisht se *"Aktet me karakter individual miratohen kurdoherë me votim të fshehtë"*.

**INFOÇIP ka konkluduar se në asnjë prej rasteve të listuara më sipër, nuk është bërë votim i fshehtë nga këshilltarët.**

**Ne rastin e këtyre vendimeve, nenii 35, pika 1 e ligjit 8652 i ngarkon Këshillit detyrimin për zhvillimin e seancave të këshillimit me bashkësinë në secilin rast, fakt të cilin monitorimi nuk e ka konstatuar.**

## Vendimet Qarkulluese

Pavarësisht se mbledhja e fundit u mbajt në 11 Janar 2013, Këshilli ka miratuar me vendim qarkullues pas kësaj date nga një vendim respektivisht ne 23 Janar, ne 28 Shkurt, ne 25 Mars dhe ne 26 Prill 2013 (VKB për ndihmën ekonomike dhe pagesat e paaftësise). Ky format vendimarrje dhe procedura që ndiqet në raste të tillë nuk parashikohet në ndonjë nga nenet e ligjit 8652, të ndryshuar. Rrjedhimisht, praktika e ndjekur për vendimet qarkulluese nga Këshilli Bashkiak Durrës, mbetet të konsiderohet ekstra ligjore.

**GJETJET E MONITORIMIT**

## 14 SHPALLJA DHE HYRJA NË FUQI E VENDIMEVE TË KËSHILLIT BASHKIAK (NENI 33/6)

Sikurse është shpjeguar edhe më sipër, ligji 8652, i udhëshme, ka bërë përcaktim të qartalish kur me procedurën e shpalljes dhe hyrjes në fuqi të vendimit e tij të Këshillave Bashkiake. "Aktet e këshillit shpalles brenda 10 ditëve nga datat e miratimit të tij, dhe hyrje në fuqi 10 ditë pas shpalljes. Aktet me karakterinë zhvillues hyjnë në fuqi në datën e njësimtë të tyre subjekteve që përfshihen në to" (nani 33/6).

Ligjvënësi është kujdesur të dallojë qartë pëntesë kësaj dispozite miratimin e imitimit të aktit nga momenti i shpalljes së tij. Shpallja në këtë rast nënkuption miratimin kur vendimi i marrë në seancë plenare nga Këshilli zhvillues nga seleretari në formën e tij përfunditare. Data e zbarësjes cakton edhe miratimin kur nis rivojtimi i vendimit subjekteve të përfshira në të. Akti administrativ konsiderohet se i është rivojtuar nga autoriteti shtetëror subjekteve të interesuara nga mo-

menti i kryerjes së atyre veprimitve që kërkon ligji për t'u quajtur akt i shpallur.


Përcaktimi paraprak i karakterit normativ apo individual të aktit (në këtë rast vendimi i Këshillit Bashkiake) është i domosdoshëm edhe në këtë rast, si kuksht përtë vlerësuar objektivisht modalitetet e ndjekura përshtypjen dhe hyrjen në fuqi të vendimeve të Këshillit Bashkiake.

Nga vlerësimi që INFOCIP ndërlidhet rezulton se vendimet e Këshillit Bashkiake, Durrës kanë një përcaktim të kujdeshëm sa i takon caktimit të tekstit e aktit të modaliteteve kohore të shpalljes dhe hyrjes së tyre në fuqi.

Rezulton setë gjitha ato kanë të përcaktuar shprehimi i përfundimit të tij, pra brenda afatit ligjor prej 10 ditësh.

Sa i takon **hyrjes në fuqi**, në tekstin e çdo vendimi është përcaktuar qartësisht se ato "hyjnë në fuqi 10 ditë mëbas shpalljes". **Kjo** është një praktikë e bazuar tërësisht në përcaktimin ligjor që normon mënyrën dhe afatet e hyrjes në fuqi të vendimeve të Këshillit Bashkiake.

Sikurse shihet praktika e ndjekur nga Këshilli Bashkiake, Durrës, referon në fakt që lëvizje e parë të dispozites 33/6, e cila është këtë rastitë përgjithësuese. Në gjykatën e autorëve të këtij studitë, fjalë e dyte: "Aktet me karakterinë zhvillues hyjnë në fuqi në datën e njësimtë të tyre subjekteve që përfshihen në to", është përfundimisht e paaplikueshme në praktikë, përshtypjet e subjekteve që përfshihen në vendim, apo të studentëve që përfshijnë bursë. Për këtë arsy, INFOCIP rekomandon hqipjen e fjalës së dyte nga pika 6 e nentit 33 (shih: *Rekomandimet*).



## 2. ZBATUESHËRIA E NENIT 34 "MBLEDHJET E HAPURA"

**Ligji 8652 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore", i ndryshuar.**

### NENI 34 MBLEDHJET E HAPURA

1. Mbledhjet e këshillit janë të hapura për publikun. Çdo qytetar lejohet të ndjekë mbledhjet e këshillit, sipas mënyrës së përcaktuar në rregulloren e këshillit.
2. Njoftimi për mbledhjen e këshillit bëhet publik në vende të caktuara nga këshilli dhe në media. Njoftimi përmban datën, vendin, orën dhe rendin e ditës së mbledhjes.
3. Këshilli, me shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve, vendos për rastet kur mbledhja bëhet e mbyllur.

### GJETJET E MONITORIMIT

#### MBLEDHJET E HAPURA (NENI 34/1)

Një ndër funksionet themelore të INFOÇIP në Durrës, gjatë vitit të dytë të punës atje ka qenë aktivizimi i pjesëmarrjes qytetare mbledhjet e këshillit bashkiak. Çdo herë në mbledhjet e këshillit kanë marrë pjesë 8-10 qytetarë të aktivizuar nga Struktura e INFOÇIP në Durrës. **Pjesëmarrja e ekipit të INFOÇIP ka qenë e garantuar në çdo mbledhje.**

Ndryshe nga një vit më parë, ku, përfat të keq, u konstatua se qytetarët dursakë rrallë herë u panë të vinin në sallë për të ndjekur mbledhjen e Këshillit, ky viti i dytë shënoi një rritje të madhe të pranisë së publikut në sallën e mbledhjeve.

Mbledhja me më shumë qytetarë në sallë ka qenë ajo e datës 11 Janar 2013, ku u miratua "**Projekt-Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Durrës** (VKB nr.123). Përshkak të efekteve të mëdha normuese që një vendim i tillë ka mbi zhvillim urban të qytetit, në sallën e mbledhjeve të Këshillit u regjistrua një pjesëmarrje lartë qytetarësh, kryesisht banorë të lagjes nr.2, e cila është klasifikuar si zonë arkeologjike e kategorisë A. Rrjeti i Transparencës Qytetare dha kontributin e vet në këtë pjesëmarrje masive gjithashtu. Shqetësimi i banorëve iu adresua në mënyrë të drejpr-drejtë këshilltarëve vendorë në seancën plenare të datës 11.01.2013. Ata kërkuan që PPV të parashikonte lejimin e ndërtimit të banesave shumëkatëshe edhe në Lagjen 2, pavarësisht faktit se ajo konsiderohet një zonë arkeologjike. Po ashtu, ata kërkuan që plani të bënte parashikime që të mundësonin më pas rikonstruksionin e banesave të tyre, një praktikë tërësisht e pamundur deri më sot për banorët e kësaj lagjeje. Përfaqësuesi i studios projektuese, e cila u nënkontraktua nga Banca Botërore për PPV të Durrësit, shpjegoi për banorët se zonat arkeologjike dhe zhvillimi apo konservimi i banesave që gjenden në këto zona, është juridikson i qeverisë qëndrore dhe e rregulluar me ligj nga Kuvendi, i detyrueshëm për t'u mbajtur parasysh si fakt gjatë

procesit të hartimit të PPV të qyteteve.

Një tjetër mbledhje me prezencë të lartë të publikut në sallë, kryesisht studentë, ka qenë ajo e datës 5 nëntor 2012, ku u diskutuan një numër i madh çeshtjesh me karakter mjedisor.

Infrastruktura e sallës në të cilën zhvillon mbledhjet Këshillit Bashkiak ka mundësi të pakta akomodimi për qytetarët. Në disa raste, edhe vetë ekipi i INFOÇIP është detyruar të ndjekë në këmbë. Është vënë re se edhe personeli i administratës së bashkisë jo gjithmonë ka karrige të mjaftueshmë përtë ndjekur mbledhjet në sallë. E njëjtë situatë konstatohet edhe për gazetarët të cilët mbulojmë me kronika eventet e mbledhjeve të Këshilit Bashkiak. Një situatë e tillë kompromenton materializimin në praktikë të garancisë kushtetuese në RSH sipas së cilës "*Kujt do i jetet mundësia të ndjekë mbledhjet e organeve të zgjedhura kolektive*" (neni 23/3 i Kushtetutës).

Problemet me natyrë infrastrukturore të sallave të mbledhjeve të Këshillave Bashkiak janë të përhapura në Shqipëri. Kjo mangësi është e justifikueshme për një pjesë të bashkive të cilat nuk kanë mundur dot të investojnë në ndërtimin e sallave bashëkohore për Këshillat Bashkiak (sip.sh në Korçë), por ngre pikëpyetje të rëndësishme për sallat e reja që janë ngritur në këto 7-8 vitet e fundit (Durrësi, Tirana, etj).

**Megjithatë, përsa i takon respektimit të dispozitës 34/1 të ligjit 8652, mund të thuhet aksesi për të ndjekur në sallë mbledhjet ka qenë ka qenë i plotë dhe i pacënuar nga Këshili Bashkiak Durrës.**

INFOÇIP rekordon gjithsesi, në kuadër të amendimeve të mundshme të ligjit 8652, të ndryshuar, që pikës 1 të nenit 34, t'i shohet edhe një fjali e tretë, në të cilën të përcaktohet shprehimisht se: "*Këshilli ka detyrim të garantojë infrastrukturën e nevojslme akomoduese për qytetarët e interesuar të ndjekin në sallë mbledhjet që ai zhvillon*" (shiko më poshtë: **Rekomandimet**).

## GJETJET E MONITORIMIT

### 2.2 NJOFTIMI I MBLEDHJEVE TË KËSHILLIT BASHKIAK (NENI 34/2)

#### 2.2.1 NJOFTIMI NË VENDE TË CAKTUARA

Në kuqtimin strikt të ligjit, në Durrës nuk gjendet ndonjë stendë në hapësirat publike të qytetit e cila të shërbejë apo të ketë shërbyer për të afishuar njoftimet përmblledhjet e Këshillit Bashkiak. Bashkia Durrës ka gjithsesi një zyrë informacioni e cila prezumohet se merr dijeni përmblledhjet e rradhës të caktuar nga Këshilli Bashkiak. Megjithatë, informimi i publikut përmes kësaj zyre do të konsiderohet i mirëqenë dhe i përbushur sa kohë që kjo zyrë ka qenë funksionale. (Ky tregues do të përllogaritet apriori në vlerë maksimale në grafikun e nivelit të implementimit të nenit 34 nga Këshilli Bashkiak).

#### 2.2.2 NJOFTIMI NË MEDIA

Durrësi, edhe pse ndër qytete më të mëdha të vendit, nuk ka patur asnjë televizion lokal. Ky bën që problematika vendore dhe aktiviteti i autoriteteve vendimarrëse të bashkisë të mos jetë objekt pasqyrimi konstant më media. Vetëm në muajt e parë të vitit 2013, nisi transmetimet një televizion i ri, i quatur ADRIATIK TV, por transmetimet e tij të para kanë qenë kryesisht programe të gatshme, si psh. filma të huaj dhe shumë pak programacion informativ.

## GJETJET E MONITORIMIT

### 2.3 MBLEDHJET E MBYLLURA (NENI 34/3)

Këshilli, me shumicën e votave të numrit të përgjithshëm të anëtarëve, vendos përmblledhja bëhet e mbyllur (Neni 34/3).

Gjatë periudhës kohore që mbuloi ky monitorim, të gjitha mbledhjet e zhvilluara nga Këshilli kanë qenë me dyer të hapura. Nuk ka patur në asnjë rast votim përmblledhjeve të zhvilluara nga Këshilli Bashkiak, e cila të fuste në veprim këtë dispozitë (34/3).

#### 2.2.3 NJOFTIMI ME MËNYRA TË TJERA

##### TELEFON, E-MAIL

Praktika kryesore e ndjekur nga Sekretariati i Këshillit Bashkiak Durrës përmblledhjet e mbledhjeve ka qenë përmes kontaktimit kryesisht me telefon, por edhe emailit, të të gjithë këshilltarëve apo të personave të tjera të interesuar. INFOCIP, si dhe të ZTQ Durrës janë njoftuar rregullisht përmes telefonit, tre katër ditë para, përmblledhjet e Këshillit Bashkiak. Kjo praktikë, edhe pse ka garantuar normalisht ndjekjen në sallë të mbledhjeve prej ekipit monitorues, ka limitet e veta objektiva përmblledhjet e mundshëm përmblledhjet e Këshillit Bashkiak.

##### WEBSITE

Një ndër mënyrat e mundshme të njoftimit të mbledhjeve mund të jetë edhe përmes internetit. Bashkia e Durrësit ka një faqe zyrtare interneti e cila ofron vazhdimesh informacione mbi aktivitetet e bashkisë. Nga vëzhgimi sistematik që INFOCIP i ka bërë kësaj faqjeje nuk rezulton që ajo të jetë përdorur përmblledhjet e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak.

#### 2.2.4 DATA, VENDI, ORA, RENDI DITËS

Një tjetër përcaktim i nenit 34, pika 2, e ligjit 8652, të ndryshuar është edhe se "Njoftimi përmban datën, vendin, orën dhe rendin e ditës së mbledhjes" (fjalia e dytë e nenit 34/2). Nga vlerësimi i të gjithë njoftimeve të shpërndara gjatë periudhës nën monitorim, rezulton se kjo kërkesë e ligjit ka qenë tërësisht e respektuar.

Rrjedhimisht, dispozita 34/3 nuk mund të jetë objekt vlerësimi në kuadër të këtij vëzhgimi, sa kohë që nuk ka patur në asnjë rast implementim të saj në praktikë.

Gjatë kësaj periudhës tre-vjeçare që INFOCIP është duke punuar në nivel të qeverisjes vendore, nuk është konstatuar në asnjë rast të vetëm zhvillimi i ndonjë mbledhjeve me dyer të mbyllura nga Këshilli Bashkiak, e cila të fuste në veprim këtë dispozitë (34/3).

### 3. ZBATUESHMËRIA E NENIT 35 "SEANCAT E KËSHILLIMEVE ME BASHKËSINË DHE E DREJTA E PUBLIKUT PËR T'U INFORMUAR"

#### Ligji 8652 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore", i ndryshuar NENI 35

##### SEANCAT E KËSHILLIMEVE ME BASHKËSINË DHE E DREJTA E PUBLIKUT PËR T'U INFORMUAR

1. Këshilli komunal ose bashkiak, përpara shqyrtimit dhe miratimit të akteve, zhvillon seanca këshillimi me bashkësinë. Seancat e këshillimit janë të detyrueshme përrastet e parashikuara në nenin 32 shkronjat "dh", "e", "f" dhe "k" të këtij ligji.
2. Këshillimi me bashkësinë, në çdo rast, bëhet sipas mënyrës së përcaktuar në rregulloren e këshillit, duke përdorur një nga format e nevojshme si takimet e hapura me banorët, takime me specialistë, me institucionet e interesuara dhe organizata joqeveritare ose nëpërmjet marrjes së nismës për organizimin e referendumeve vendore.
3. "2/1. Për këshillat komunale/bashkiake janë te detyrueshme seancat e këshillimit me kryetaret dhe kryesine e fshatrave nen juridiksim, ne përputhje me përcaktimet e bëra ne shkronjat "ç", "dh", "e", "f", "k" dhe "ll" te nenit 32 te ligjit. Seancat e këshillimit, ne këtë rast, shënohen ne procesverbal.
3. Aktet e këshillit qfishohen, në vende publike të caktuara nga këshilli, brenda territorit të komunës ose bashkisë dhe, sipas mundësive, këshilli cakton edhe forma të tjera të publikimit të tyre. Informimi i publikut në çdo komunë e bashki bëhet në përputhje me ligjin nr.8503, datë 30.6.1999 "Për të drejtën e informimit përr dokumentet zyrtare" dhe rregullat e përcaktuara nga vetë këshilli përkates për këtë qëllim.

#### GJETJET E MONITORIMIT

### 3.1 KËSHILLIMI ME BASHKËSINË (neni 35/1 dhe 35/2)

Konkrektisht, Seancat e këshillimit me bashkësinë janë të detyrueshme kur Këshilli:

- dhe) Miraton buxhetin dhe ndryshimet e tij.
- e) Miraton tjetërsimin ose dhënien në përdorim të pronave të tretëve.
- f) Vendos përraksat e tarifat vendore, si dhe nivelin e tyre.
- k) Miraton norma, standarde e kriterëve përrregullimin dhe disiplinimin e funksioneve që i janë dhënë atij me ligj, si dhe përmbrojtjen dhe garantimin e interesit publik.

Këshillimi me bashkësinë, në ratin e Këshillit Bashkiak Durrës, bëhet duke përdorur takimet e hapura me banorët, takime me specialistë, me institucionet e interesuara dhe organizata joqeveritare. Ky proces facilitohet nga INFOCIP prej dy vitesh.

#### 3.1.1. KONSULTIMI ME PUBLIKUN PËR BUXHETIN DHE PAKETËN FISKALE (GERMAT "dh" & "f")

Gjatë periudhës që mbuloi ky monitorim, Këshilli Bashkiak i Durrës nuk kaloi dot buxhetin e vitit 2013 dhe as Paketën Fiskale 2013, apo siç njihem ndryshe Taksat & Tarifat vendore (këto miratohen gjithonë para Buxhetit). Kjo është një situatë e paprecedentë dhe mjaft serioze, po të mbahet parasysh se kemi të bëjmë me vendimarrjen më kryesore që një këshillill vendor ka për detyrë të realizojë.

Në fakt, procesi vendimarrës për Paketën Fiskale 2013 u nis, por mbeti në mes i pa-finalizuar, siç kuptohet edhe nga korrespondenca zyrtare e Këshillit me Prefektin. Në shkresën me **nr prot. 2114** thuhet sa vijon: "Në dt. 20/02/2013 u zhvilluar një mbledhje me kryetaret e grupeve e cila mori në shqyr-

tim materialet e paraqitura nga administrata e bashkise dhe caktoi mbledhjen e rradhës së Keshillit Bashkiak Durres përtuzhvilluarne date 25.02.2013, ku pjesë e rendit të ditës ishte dhe diskutimi dhe votimi i Paketës Fiskale 2013. Komisioni i Ekonomisë, në mbledhjen e tij me date 25.02.2013, mori ne analize projekt-vendimin e paraqitur nga administrata e Bashkise "Paketa Fiskale per Vitin 2013". Gjate mbledhjes u diskutua fakti i mos zbatimit te nenit 33 ligji 9632 date 30.10.2006 i ndryshuar me ligj nr.10117 date 23.04.2009 "Taksat e Perkohshme Vendore", si një problem i paraqitur nga biznesi i vogel. Ne perfundim te mbledhjes u kerkua kohe nga anetaret e Partise Socialiste per interpretimin ligjor te nenit perkates dhe njekohesisht, u kerkua anulimi i mbledhjes se njoftuar te keshillit bashkiak date 25.02.2013 (lajmerim i bere elektronikisht per te gjithe keshilltarët si dhe mediat lokale, shih faksimile fq 29)".

#### 3.1.2. KONSULTIMI ME PUBLIKUN PËR TJETËRSIMIN E PRONAVE (GERMA "e")

Gjatë periudhës që mbuloi ky monitorim, janë marrë 5 vendimesh përraksat e tjetërsimin ose dhënien në përdorim të pronave të tretëve. Monitorimi nuk konstatoi ndërmarrjen e asnjë konsultimi publik (sipas modelit që realizohet përraksat e tjetërsimin ose dhënien në përdorim të pronave të tretëve). Nuk përfjashtohet megjithatë që të jenë zhvilluar konsultime të ngushta me palë apo persona të interesuar në nivel komisionesh të këshillit përraksat e tjetërsimin ose dhënien në përdorim të pronave të tretëve.

### 3.1.3 KONSULTIMI ME PUBLIKUN PER NORMA DHE STANDARTE (GERMA "K")

Gjatë periudhës kohore që u monitorua, Këshilli miratoi “**Planin e Përgjithshëm Vendor**”, që përcakton normën bazë urbanistike të qytetit të Durrësit për të paktën 10 vitet e ardhshme. Kjo vendimarrje shumë e rëndësishme iu nënshtrua fillimi i konsultimeve me grupe interesit që u organizuan nga administrata e bashkisë Durrës. Pas përfundimit të kësaj faze, Këshilli Bashkiak, në respekt të detyrimit ligjor shpalli axhendën e tij të diskutimit publik të projekt-**Planit të Përgjithshëm Vendor**. Eventi konsultativ u organizua nga INFOÇIP dhe struktura e saj lokale në Durrës, në kuadër të partneritetit me Këshillin Bashkiak Durrës, si një ndër objektivat e parashikuar të fazës së dyte të projekteve në Durrës. Takimi me mbi 70 pjesëmarrës u zhvillua në datë 15 Djetor tek Hotel Adriatik në Durrës. Pjesëmarrësit ishin krye sish arkitektë, urbanistë, inxhinierë injedisore, ndërtues, zhvillues pronash, qytetarë, etj.

Projekt-**Plani** u paraqit nga përfaqësuesi i studios projekteve Dr.Urb.Ing. Athanasios Pagonis, (T.P. Development Group).

Një çështje që u diskutua nga arkitektet dhe urbanistet durrasakë të pranishem ishte oponanca teknike e pamjaftueshme e projekt-planit. U kërkua ngrija e së një komisioni ad-hoc teknik pranë Këshillit Bashkiak përsqyrtimin paraprak të planit para aprovimit përfundimtar. Ky proces u konsideruar i një rendesie te posacme, perte shnagur defekte te mundshme ne planifikimin e qytetit, apo per t'i prere rrugen fenomeneve negative qe kane shoqeruar ne keto vitet e fundit zhvillimin kaotik urban te Durrenit (*për më shumë kliko: <http://www.infocip.org/al/?p=10071> ose shikoje plotë eventin konsultativ në audio-video tek: <https://vimeo.com/55844750>* ).

Këshilli Bashkiak Durrës miratoi me shumicë votash ‘**Planin për Zhvillimin Vendor dhe Rregulloreën për Qytetin e Durrësit**’ në mbledhjen e tij të datës 11 Janar 2013.

Mbledhja zgjati mbi 2 orë dhe u shoqërua me debate pasi plani nuk ishte shumë i detajuar, dhe nuk imbulonte fare çështje sensitive zhvillimit urban të qytetit. Kryetari i bashkise Durrës, z. Dako, i pranishëm në sallë kërkoi që përfaqësuesit e Studios Urbanistike, por edhe këshilltarët t'i jepnin një përgjigje banoreve të lagjes 11, një zonë arkeologjike kjo e klasit A, se përsë pikerisht kjo lagje ishte e përashtuar nga ky plan zhvillimi. Banorët kërkuan me ngulim në sallë që edhe zona e tyre të trajtohet me plan zhvillimi duke vënë në dukje gjendjen e vështirë të banesave ku ata jetojnë. Z. Athanasios Pagonis, përfaqësues i studios urbanistike shpjegoi se plani është hartuar duke mbajtuar parasysh jo thjesht dhe vetem interesin imediat te banoreve te lagjes 11, por

### VENDIMARRJA E KONSULTUAR



edhe interesin kombëtare, duke respektuar të gjitha ligjet e shtetit shqiptarë për zonat arkeologjike, ku nuk lejohen ndërhyrje me anë të planeve të tilla.

Banoret e lagjes 11, prezent ne sallë, ngriten shqetësimet e tyre, duke kerkuar “leje” qoftë edhe per te rikonstruktuar shtepite e tyre, proces edhe ky i pamundur tanë per tanë. Ky ballafaqim direkt mes një pale te interesuar dhe vendimarreseve të Durrësit në pushtetin vendor shënon edhe te parin e regjistruar ne keto tre vitet e fundit që INFOÇIP po punon në Durrës për të rritur ndërveprimin e publikut me Këshillin Bashkiak gjatë procesit vendimarrës.

Përshtumi kliko: <http://www.infocip.org/al/?p=10252> ose shikoje mbledhjen e këshillit bashkiak në audio-video tek: <https://vimeo.com/57681028#>

## GJETJET E MONITORIMIT

### 3.2 AFISHIMI I VENDIMEVE TË KËSHILLIT BASHKIAK (*nëni 35/3*)

Objekt vlerësimi në kuadër të këtij Raporti do të jetë vetëm pjesa e parë e dispozitës, pikërisht ajo që adreson **informimin proaktiv** të vendimeve të Këshillit. Pjesa e dytë, e cila referon ligjin nr.8503, datë 30.6.1999 „Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”, dhe që në fakt klasifikohet si **informim aktiv i publikut** (*pasi vihet më lëvizje përmes kërkesave të këtij të fundit*) nuk analizohet nga metodologjia e pëdorur për këtë monitorim.

Niveli i zbatimit të nenit 35 pika 3 nga Këshilli Bashkiak Durrës deri në momentin e implementimit të këtij projekti nga INFOÇIP dyjet më parë në Durrës ka qenë më pak se minimal. Sa i takon afishimit të vendimeve, në kuptimin e një veprimi të ndërmarrë direkt nga administrata bashkiane në një stendë të vendosur në një vend publik, mund të thuhet se një praktikë e tillë nuk është konstatuar asnjëherë në Durrës. Edhe forma të tjera publikimi, si siç mund të janë ato përmes Gazetës Zyrtare lokale apo ndonjë tjetër botimi perodik që nxjerr pushteti vendor, nuk janë konstuar para dhe gjatë kohës së këtij monitorimi. Sa i takon faqes zyrtare në internet, bashkia Durrës ka aplikuar deri para dy vjetësh një model publikimi rudimentar, vetëm të titullit të vendimeve të marra në harkun kohor të një viti (*përbajta e tyre mbetej e panjohur*).

#### DATABAZA ONLINE E VENDIMEVE

Për të adresura këtë problem, i cili, për hir të së vërtetës është jo vetëm i Durrësit, por i gjithë bashkive dhe komunave të Shqipërisë, INFOÇIP, që në fillim vendosi të dixhitalizonte dhe të hidhë online të gjitha vendimet që do të merrte Këshilli Bashkiak gjatë ushtrimit të funksioneve të tija vendimarrëse. Për më tepër, u vendos që pjesë e kësaj databaze të ishin të gjitha vendimet e marra edhe nga këshilli Bashkiak paraardhës, që ushtroi mandatin e tij në periudhën 2007-2011.

Në datë 29 Shtator 2011, Qendra për Çështje të Informimit Publik dhe dega e saj në Durrës, Zyra për Transparencë Qytetare i dhuruan zyrtarisht Bashkisë Durrës dhe gjithë qytetarëve durrsakë Databazën Online të Vendimeve të Këshillit Bashkiak.

Ndërkohe, në periudhën Nëntor 2012-Shkurt 2013, INFOÇIP hodhi nga e parë online, në një platformë krejt të re, të quajtur [www.vendime.al](http://www.vendime.al) të gjitha vendimet ekzistuese që më parë ishin të “arkivuara” në [www.infocip.org](http://www.infocip.org)

Databaza e re është linkuar në faqen zyrtare të Bashkisë Durrës.

#### Çfarë është VENDIME.AL

[www.vendime.al](http://www.vendime.al) është një databazë e fuqishme online ku publikohen vendimet e këshillave bashkikë.

[www.vendime.al](http://www.vendime.al) ofron akses efektive në një portal të vetëm online, për njohjen e vendimarrjes vendore në secilën bashki të Shqipërisë, pa pagesë dhe në çdo kohë.

[www.vendime.al](http://www.vendime.al) është emërtimi i shkurtuar në internet për: **Arkiva Kombëtare e Vendimeve të Këshillave Bashkiakë në Republikën e Shqipërisë**.

[www.vendime.al](http://www.vendime.al) është konceptuar dhe ndërtuar nga Qendra për Çështjet e Informimit Publik, INFOÇIP. Ajo është në përditësim dhe në zgjerim të vazhdueshëm, tashmë edhe me kontributin direkt të bashkive përftyuese, të cilat kanë akses të individualizuar në hedhjen e vendimeve të tyre.

[www.vendime.al](http://www.vendime.al) është e pajisur me dy motorë kërkimi të fuqishëm (kërkim i thjeshtë dhe i avancuar), të vendosur në faqen kryesore të portalit.

**Kërkimi i Thjeshtë**, kërkoni/identifikoni VKB-të e synuara përmes "fjalë-kyçeve". Këto duhet të shkruhen brenda në fushën e kërkimit dhe më pas të pasohen nga shtypja e komandës "Kérko", ose duke klikuar direkt "Enter" në tastierë.

**Kërkimi i Avancuar** realizohet përmes atributeve të vendimit, duke zgjedhur më parë bashkinë përkatëse. Ky motor kërkimi është autentik, pasi është dizenjuar në funksion të praktikës shqiptare për caktimin e atributeve të akteve që nxjerrin vendimarrësit vendorë. Ky motor kërkimi ka praktikisht një precision maksimal në identifikimin dhe shfaqjen e vendimit të kërkuar.

Në faqen kryesore, gjendet edhe butoni "NDIHME", me shpjegimet e nevojshme për një kërkim sa më efektiv në [www.vendime.al](http://www.vendime.al)

Ja ku mund ti shfletoni vendimet e Këshillit Bashkiak nga faqja zyrtare e Bashkisë Durrës

Këtu mund të shikoni gjithashtu edhe të gjitha mbledhjet e Këshillit Bashkiak Durrës, në audio dhe video.

Edhe video-arkiva është realizuar dhe mirëmbahet nga INFOCIP. Ajo përmban të gjitha mbledhjet e Këshillit që nga viti 2011.

## Video-arkiva e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak, Durrës

Për të adresuar efektivisht për zgjidhje problemin e ndjekjes së mbledhjeve, INFOCIP ndërmori një proces relativisht të komplikuar për ndërtimin e një videoarkive online, në të cilin të ngarkoheshin të gjitha mbledhjet e Këshillit, përfshirë konsultimet publike të ndërmarrja prej tij në kuadër të ndëveprimit me INFOCIP dhe ZTQ Durrës, për t'i dhënë në këtë mënyrë gjithsesicil mundësi për të ndjekur procesin vendimorrës të këshillit. Video-arkiva është materializim konkret i aplikimit të teknologjive të reja të informacionit në promovimin e transparencës vendimorrëse në nivel vend.

Qytetorët e Durrësit kanë tashmë mundësi që të ndjekin mbledhjet e Këshillit Bashkiak online, përmes faqes së INFOCIP, [www.infcip.org](http://www.infcip.org), e linkuar tashmë në faqen zyrtare të Bashkisë Durrës. Të gjitha mbledhjet e zhvilluara nga Këshilli i ri Bashkiak që doli pas zgjedhjeve të Majit 2011 janë filmuara nga INFOCIP dhe më pos jashtë hedhur online në një video-arkivë moderne. Kjo qasje unike i jep një dimension të ri transparencë veprimitarë vendimorrës të Këshillit Bashkiak, Durrës, duke e bërë atë keshtu të vetmin në Republikën e Shqipërisë, që disponon një video-arkive të mbledhjeve të tjera. Për më shumë kliko: [http://www.infcip.org/al/?page\\_id=271](http://www.infcip.org/al/?page_id=271)

## 4. ZBATUESHMËRIA E AFATEVE FUNKSIONALE

### Ligji 8652 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore", i ndryshuar.

#### NENI 19

##### BUXHETI I NJËSIVE TË QEVERISJES VENDORE

4. Miratimi i buxhetit të ri dhe mbyllja e buxhetit të viti të mëparshëm bëhet sipas afateve të përcaktuara në ligjin nr.8379, datë 29.7.1998 "Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë".
5. Buxheti i çdo njësie të qeverisjes vendore miratohet nga këshilli përkatës. Miratimi i buxhetit dhe i bilancit të tij mbyllës, bëhen në afat e përcaktuara në ligjin nr. 8379, datë 29.7.1998 "Për hartimin dhe zbatimin e Buxhetit të Shtetit të Republikës së Shqipërisë".

#### NENI 27

##### MANDATI I KËSHILLTARIT

4. Mandati i këshilltarit mbaron përparrë afatit, me propozimin e komisionit të mandateve kur:
- e) nuk merr pjesë në mbledhjet e këshillit për një periudhë 6-mujore;

#### NENI 31

##### FUNKSIONIMI I KËSHILLIT BASHKIAK.

8. Kur këshilli nuk mblidhet për shkak të mungesës së anëtarëve të tij gjatë tre muajve, duke filluar nga data e mbledhjes së fundit të tij, këshilli quhet i vetëshpërndarë. Vetëshpërndarja pasohet me zgjedhje të reja për këshillin përkatës dhe sekretari i këshillit komunal ose bashkiak, brenda 10 ditëve nga përfundimi i afatit 3-mujor, njofton prefektin

#### NENI 38

##### SHPËRNDARJA E PARAKOHSHME E KËSHILLIT KOMUNAL OSE BASHKIAK

1. Këshilli komunal ose bashkiak shpërndahet para kohe me vendim të Këshillit të Ministrave kur:
- a) nuk mblidhet për një periudhë të vazhdueshme tremujore;
- b) nuk arrin të marrë vendim për miratimin e buxhetit brenda tre muajve nga data e përcaktuar në nenin 19 të këtij ligji;
- c) kryen shkelje të rënda të Kushtetutës ose ligjeve.
2. Këshilli komunal ose bashkiak shpërndahet edhe kur bëhet riorganizim me ndryshim kufijsh, sipas nenit 70 të këtij ligji.
3. Në rast të lënies në fuqi të vendimit të shpërndarjes nga organi kompetent, në komunën ose bashkinë përkatëse organizohen zgjedhjet për këshillin, në përputhje me Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë.

Gjatë periudhës nën monitorim, 26 Korrik 2012- 12 Korrik 2013, Këshilli Bashkiak Durrës ka zhvilluar një aktivitet të reduktuar vendimarrës, përsye që mbenet për t'u shpjeguar prej vetë atij. Nga monitorimi rezulton se përgjatë 12 muajve, Keshilli u mblodh vetëm 3 herë në seancë plenare, respektivisht në datat 1 Tetor dhe 5 nëntor 2012, dhe njëherë të fundit në dt. 11 Janar 2013. Që nga kjo datë, këshilli nuk u mbledh më, duke bërë që të shkaklet si fillim pika 2 e nenit 31 të ligjit 8652, që përcakton se "**Mbledhjet e radhës të këshillit bashkiak zhvillohen si rregull jo më pak se një herë në muaj**".

Në datë 11 Prill 2013, Këshilli Bashkiak Durrës kapërceu edhe limitin e fundit ligjor prej tre muajsh rradhazi pa u mbledhur në seancë, duke konsumuar kështu rrethanën ligjore të parashikuar në nenin 38 "**Shpëndarja e parakohshme e këshillit**", ku, në pikën 1 të tij, germa "a" thuhet shprehimisht se **Këshilli komunal ose bashkiak shpërndahet para kohe me VKM kur nuk mblidhet për një periudhë të vazhdueshme tremujore;**

Këtë rrethanë limit, ligji 8652 e parashikon edhe në nenit 31, pika 8 ku shprehimisht thuhet se "**Kur**

**këshilli nuk mblidhet për shkak të mungesës së anëtarëve të tij gjatë tre muajve, duke filluar nga data e mbledhjes së fundit të tij, këshilli quhet i vetëshpërndarë. Vetëshpëndarja pasohet me zgjedhje të reja për këshillin përkatës dhe sekretari i këshillit komunal ose bashkiak, brenda 10 ditëve nga përfundimi i afatit 3-mujor, njofton prefektin**". Në datë 19 Prill 2013, Prefekti, që është institucion mbikqyrës i Këshillit Bashkiak, mori dijeni nga sekretaria e Këshillit Bashkiak për situatën e krijuar me shkresen me nr. prot. 2114. Letra zyrtare me subjekt: Kërkësë për Interpretim", është firmosur zyrtarisht edhe nga kryerari i Këshillit Bashkiak. Kjo korrespondence (shih faksimile) është konform përcaktimit ligjor dhe është realizuar brenda afateve që lë në dispozicion pika 8 e nenit 31 të ligjit 8652 (brenda 10 ditëve)

Në letër thuhej: Në dt. 20/02/2013 u zhvilluar një mbledhje me kryetaret e grupeve e cila mori ne shqyrtim materialet e paraqitura nga administrata e bashkise dhe caktoi mbledhjen e rradhës së Keshillit Bashkiak Durrës për t'u zhvilluar me date 25.02.2013, ku pjesë e rendit të ditës ishte dhe diskutimi dhe votimi i Paketës Fiskale 2013. Komisio-

ni i Ekonomise, ne mbledhjen e tij me datë 25.02.2013, mori ne analize projekt-vencimini e paracitër nga administrata e Bashkise „Paketa Fiscale për Vitin 2013“. Gjatë mbledhjes u diskutua fakti i mos zbatimit te nenit 33 ligji 9632 datë 30.10.2006 i ndryshuar me ligj nr. 10117 datë 23.04.2009 „Taksat e Perkoħshme Vençore“, si oje problemi i paracitër nga biznesi i vogel. Ne perçençim te mbledhjes u kerkua kohë nga anetaret e Partise Socialiste per interpretimin ligjor te nenit perçates qhe nje cohesisht, u kerkua anullimi i mbledhjes se njoftejte keshillit bashkiak datë 25.02.2013 (lajmej i hec ne menye elektronike per te gjithe anetaret e keshillit si qhe mediat lokale).

Gjatë periuðhës 12 muajve nën monitorin, Keshilli Bashkiak Durrës nuk realizoi çot as vendimari jet pë: **Paketën Fiskale 2013** (valesi është iktishë vendos) qhe pë:

**Buxhetin 2013** (pagave administrative, investimzi publike, etj). Këto janë në fakt që vendimari jet më të rënëcësish me vjetore të tij. Mos-realizimi i tyre çon gjithashtu në shpërndajjen e parakohshmetë Keshillit Bashkiak, sic parashikon nenin 38, pika 1, gjenna "b", ku shprehimisht thhet se: **Keshilli shperndahet me VKM kur nuk arrin të marrë vendim për miratimin e buxhetit brenda tre muajve nga data e përcaktuar në ueni 19 të këtij ligji**.

Në datë 12 Korrik 2013, u mbushen gjithashtu plot 6 muaj nga hera e fëncit e keshillta është Durrësit kanë marrë pjesë në një mbledhje të keshillit (e fëncit ka qenë në 11 Janar 2013). Nen 27 i ligjit 8652, në pikën 1, gjenna "c" përcakton shprehimisht se: **Mandati i këshilltarit, nbaron para afatit, me propozim të komisionit të mandateve kur: e) nuk nierr në mbledhjet e këshillit për një periudhë 6 muajore.**





## PJESA E TRETË

**PËRMBLEDHJE E KONKLUZIONEVE  
( EKSTRAKT EKZEKUTIV )**



# 3

## PËRMBLEDHJE E KONKLUZIONEVE (EKSTRAKT EKZEKUTIV)

### I. FUNKSIONIMI I KËSHILLIT BASHKIAK (*intensiteti & afatet*)

Gjatë periudhës nën monitorim, 26 Korrik 2012- 12 Korrik 2013, Këshilli Bashkia Durrës zhvilloi një aktivitet të reduktuar vendimarrës, për arsy që mbeten për t'u shpjeguar prej vetë atij. Nga monitorimi rezulton se përgjatë 12 muajve, Këshilli Bashkiak u mblodh vetëm 3 herë në seancë plenare, respektivisht në datat 1 Tetor 2012, 5 Nëntor 2012 dhe njëherë të fundit në datë 11 Janar 2013. Që nga kjo datë, Këshilli nuk u mblodh më në seancë të rregullt, duke bërë që të shkelet si fillim nenit 31, pika 2 e ***ligjit 8652, të ndryshuar***, që përcakton shprehimisht se “***Mbledhjet e radhës të këshillit bashkiak zhvillohen si rregull jo më pak se një herë në muaj***”.

Në datë 11 Prill 2013, Këshilli Bashkiak Durrës kapërceu edhe limitin e fundit ligjor prej tre muajsh rradhazi pa u mbledhur në seancë, duke konsumuar kështu rrethanën ligjore të parashikuar për veshpërndarjen e tij, siç parashikohet qartë në nenin 38 “***Shpërndarja e parakohshme e këshillit***”, ku, në pikën 1 të tij, germa “a” thuhet shprehimisht se ***Këshilli komunal ose bashkiak shpërndahet para kohe me VKM kur nuk mblidhet për një periudhë të vazdueshme tremujore***.

Po ashtu, edhe neni 31 “***Funksionimi i këshillit***”, pika 8 përcakton shprehimisht në pikën 8 të tij se “***Kur këshilli nuk mblidhet për shkak të mungesës së anëtarëve të tij gjatë tre muajve, duke filluar nga data e mbledhjes së fundit të tij, këshilli quhet i vetëshpërndarë. Vetëshpërndarja pasohet me zgjedhje të reja për këshillin përkates dhe sekretari i këshillit komunal ose bashkiak, brenda 10 ditëve nga përfundimi i afatit 3-mujor, njofton prefektin***”. Në datë 19 Prill 2013, sekretarja e Këshillit Bashkiak, me një shkresë të sigluar edhe nga kryetari i Këshillit, me nr. prot. 2114, ka njoftuar prefektin për situatën në fjalë. Kjo korrespondence zyrtare është konform kërkuesave të ligjt dhe brenda afateve që lë në dispozicion pika 8 e nenit 31, fjalia e dytë (shih faksimilet, fq 29).

Gjatë periudhës nën monitorim, Këshilli Bashkiak Durrës nuk ralizoi dot as vendimarrjet për ***Patketën Fiskale 2013*** (*taksat dhe tarifat vendore*) dhe për ***Buxhetin 2013*** (*pagat e administratës, investimet publike, etj*). Këto janë në fakt dy vendimarrjet më të rëndësishme vjetore të tij. Mos-realizimi i vendimarrjes përbuxhetit posaçërisht çon gjithashtu në shpërndarjen e parakohshme të Këshillit Bashkiak. Kjo parashikohet nga nenit 38, pika 1, germa “b”, ku shprehimisht thuhet se: ***Këshilli shperndahet me VKM kur nuk arrin të marrë vendim përmiratimin e buxhetit brenda tre muajve nga data e përcaktuar në nenit 19 të këtij ligji***.

Në datë 12 Korrik 2013, u mbushën gjithashtu plot 6 muaj nga hera e fundit kur këshilltarët e Durrësit morën pjesë në një mbledhje të Këshillit (e fundit ka qenë ajo në datë 11 Janar 2013). Neni 27 i ***ligjit 8652, të ndryshuar***, në pikën 4, germa “e” përcakton shprehimisht se: ***Mandati i këshilltarit, imbaron para afatit, me propozim të komisionit të mandateve kur: e) nuk merr në mbledhjet e këshillit për një periudhë 6 mujore***. INFOCIP shpalli publikisht rezultatet e këtij monitorimi në datë 13 Korrik 2013, pikërisht një ditë pas skadimit edhe të këtij afati i cili aplikohet në këtë rast mbi këshilltarin si subjekt individual dhe jo mbi këshillin si entitet.

## II. AKTIVITETI VENDIMARRËS KËSHILLIT BASHKIAK

### VOTIMI I VENDIMEVE

Gjatë 12-mujorit të dytë të ushtrimit të mandatit, Këshilli Bashkiak, Durrës ka miratuar gjithsej 70 vendime. Plot 38 prej tyre janë marrë në vitin 2012, kurse pjesa tjeter i takojnë vitit 2013. Shumica dërrmuese e vendimeve të Këshillit janë me karakter individual (66 gjithsej). Nga monitorimi rezulton se këshilltarët kanë bërë votim të hapur në të gjitha rastet, në kundërshtim me paragrafin 1 të nenit 33 **"të ligjit 8652, të ndryshuar"**, që përcakton shprehimi që "Aktet me karakter individual miratohen kurdoherë me votim të fshehtë".

Për periudhën e monitoruar, vetëm 4 vendime (VKB) kanë karakter normativ. Në të katra rastet, votimi është bërë i hapur, konform përcaktimit ligjor. Më i rëndësishmi prej tyre është VKB nr.123 **"Për Miratin e Projekt-Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Durrës"**. Përpara votimit të këtij vendimi, Këshilli ndërmori konsultime me aktorë të interesit dhe publikun, konform detyrimit që i ngarkon atij pika 1 e nenit 35 të **"ligjit 8652, të ndryshuar"**. Takimi me pjesëmarrje masive (tek Hotel Adriatik) u organizua dhe u mbështet nga INFOÇIP me strukturat e veta në Durrës, në kuadër të partneritetit me Këshillin Bashkiak që vijon prej më shumë se dy vjetësh tashmë.

### VENDIME QË MERREN ME TRE TË PESTAT

**Ligji 8652, i ndryshuar**, parashikon vetëm një rast vendimarje për të cilën nevojiten 3/5 e votave të të gjithë anëtarëve të Këshillit, konkretisht "për rastet e parashikuara në nenin 32 shkronja "e" e këtij ligji", ose e thënë ndryshe, në rastet kur Këshilli miraton **tjetërsimin ose dhënien në përdorim të pronave të tretëve**. Gjatë 12 muajve që mbuloi monitorimi, Këshilli Bashkiak ka marrë të paktën 5 vendime për tjetërsimin ose dhënien në përdorim të pronave të tretëve. Në të gjitha këto raste votimi ka qenë pothuajse unanim dhe pika 4 e nenit 33 te ligjit 8652 është respektuar.

Ne rastin e këtyre vendimeve, nen 35, pika 1 e ligjit 8652 i ngarkon Këshillit detyrimin për zhvillimin e seancave të këshillimit me bashkësinë në secilin rast, fakt të cilin monitorimi nuk e ka konstatuar.

Po ashtu, në rastin e këtyre vendimeve, duhet edhe vlerësuar me kujdes edhe mënyra e votimit, e cila, sa kohë që ato janë për nga natyra VKB individuale, duhet të jetë gjithmonë e fshehtë. Edhe në këtë rast, Këshilli nuk e ka plotësuar detyrimin ligjor që buron nga pika 1 e Neni 33 të ligjit 8652.

### VENDIMET QARKULLUESE

Pavarësisht se mbledhja e fundit u mbajt në 11 Janar 2013, Këshilli ka vijuar të miratojë vendime me praktikë qarkulluese edhe as kësaj date, respektivisht ne 23 Janar, ne 28 Shkurt, ne 25 Mars dhe ne 26 Prill 2011, (VKB për ndihmën ekonomike dhe pagesat e paaftësisë). Një praktikë e tillë vendimarrëse dhe procedura që ndiqet në raste të tillë nuk parashikohet në ndonjë nga nenet e **"ligjit 8652, të ndryshuar"**. Kjo praktikë, e cila është ndjekur dhe në vitin 2012 nga Këshilli Bashkiak Durrës, mbetet të konsiderohet ekstra-ligjore.

### PJESEMARRJA QYTETARE

Gjatë periudhës nën monitorim, mbledhjet e këshillit kanë qenë janë të hapura për publikun, në respekt të përcaktimeve te **nenit 34 të ligjit 8652, të ndryshuar**. Qytetarët, përfshirë dhe ata të organizuar nga INFOÇIP kanë ndjekur normalisht mbledhjet e këshillit në sallë. Pjesëmarrja më e madhe e verejtur ka qenë ajo në mbledhjen datës 11.01.2013 ku u miratua edhe **"Projekt-Planit të Përgjithshëm Vendor të Bashkisë Durrës"** (VKB nr.123, dt. 11.01.2013), kur në sallën e mbledhjeve të Këshillit kishin ardhur mbi 20 banorë të lagjes nr.2 (zonë arkeologjike e Kategorisë A). Ata i kërkuan drejpdrejt këshilltarëve në seancë që PPV të parashikonte lejimin e ndërtimit të banesave ose të paktën rikonstruksion e atyre ekzistuese në Lagjen nr. 2, pavarësisht faktit se ajo eshte zonë arkeologjike.

Infrastruktura e sallën e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak ka gjithsesi mundësi të pakta akomodimi për qytetarët. Është vënë re se edhe personeli i administratës së bashkisë jo gjithmonë ka karrige të mjaftueshmë për të ndjekur mbledhjet në sallë. E njëjtë situatë konstatohet edhe për gazetarët të cilët mbulojmë me mbledhjeve të Këshillit Bashkiak. Një situatë e tillë kompromenton materializimin në praktikë të garancisë kushtetuese në RSH sipas së cilës "*Kujtido i jepet mundësia të ndjekë mbledhjet e organeve të zgjedhura kolektive*"(neni 23/3 i Kushitetutës).

## NJOFTIMI I MBLEDHJEVE

Praktika kryesore e ndjekur nga Sekretariati i Këshillit Bashkiak Durrës për njoftimin e mbledhjeve ka qenë përmes konktaktimit me email dhe me telefon, të këshilltarëve apo të personave të tjera të interesuar. INFOCIP, si dhe të ZTQ Durrës janë njoftuar rregullisht përmes telefonit, tre katër ditë para, për mbledhjet e Këshillit Bashkiak. Kjo praktikë, edhe pse ka garantuar normalisht ndjekjen në sallë të mbledhjeve prej ekipit monitorues, ka limitet e veta objektiva për të ofruar njoftimin e të të gjithë të interesuarve të mundshëm për të ndjekur mbledhjet e Këshillit Bashkiak, si ne kuptimin praktik, ashtu edhe ate të percaktuar ne pikën 2 te nenit 34 të ligjit 8652.

Edhe pse jo një kërkesë direkte e **ligjit 8652, të ndryshuar**, një ndër mënyrat e mundshme të njoftimit të mbledhjeve mund të ishte ajo përmes internetit. Nga vëzhgimi sistematik që INFOCIP i ka bërë faqes zyrtare të Internetit gjatë periudhës së monitorimit, nuk rezultoi që ajo të jetë përdorur për të publikuar njoftime lidhur me datën, orën dhe axhendën e mbledhjeve të Këshillit Bashkiak.

Sa i takon njoftimit përmes medias, kjo praktike mbecet te verifikohet ne muajt qe vijne, pasi deri ne Shkurt 2013, Durresi nuk ka patur një televizion lokal, sinjal i të cilët të perdorej per njoftimin e mbledhjeve te keshillit, sipas kuptimit që ligji i jep kësaj procedure.

## DATA, VENDI, ORA DHE RENDI I DITËS I MBLEDHJES SË KËSHILLIT

Një tjetër përcaktim i nenit 34, pika 2, e ligjit 8652, të ndryshuar është edhe se "*Njoftimi përmban datën, vendin, orën dhe rendin e ditës së mbledhjes*" (fjalia e dyte e nenit 34/2). Nga vlerësimi i të gjithë njoftimeve të shpërndara gjatë periudhës nën monitorim, rezulton se kjo kërkesë e ligjt ka qenë tërësisht e respektuar nga ana e sekretarit të Këshillit Bashkiak.

## PUBLIKIMI I VENDIMEVE

Neni 35 i ligjit 8652 i ndryshuar pëercakton shprehimisht se "Vendimet e këshillta fitoshken, në vende publike të caktuara nga këshilli, brenda territorit të komunës ose bashkisë dhe, sipas mundësive, këshilli cakton edhe forma të tjera të publikimit të tyre". Duke parë situatën shqetësuese, në vitin 2011 INFOCIP dixhitalizoi vendimet e Këshillit Bashkiak Durrës. Çdo vendim i marrë nga Këshillit që nga vitit 2007 e deri sot, është i publikuar online dhe i aksesueshëm prej gjithkuqit.

Në fillim të këtij viti (2013), databaza dixhitale e vendimeve të Këshillit Bashkiak u rihodh nga e para në portalin e ri online, [www.vendime.al](http://www.vendime.al), që ofron avantazhe maft të rendësishme krahasuar me sistemin e vjetër të arkivimit, sidomos përsa i takon gjetjes së vendimeve online me fjalë kyçë nga cili do të interesuar. Faqja e individualizuar për Durrësin ([www.vendime.al/durrres/](http://www.vendime.al/durrres/)) është e linkuar në faqen zyrtare të bashkisë Durrës. Sekretari i Këshillit Bashkiak, në bashkëpunim me strukturat vendore të INFOCIP, kanë përcjell për publikum online në [www.vendime.al](http://www.vendime.al) të gjitha vendimet që ka nxjerë Këshilli gjatë periudhës nën monitorim, në respekt të kërkesave të nenit 35 të **ligjit 8652, të ndryshuar**.





# **PJESA E KATËRT**

**REKOMANDIME  
DHE METODOLOGJIA**





# REKOMANDIME

## → I. PROBLEMI KRYESOR I IDENTIFIKUAR

INFOÇIP konstaton se Këshilli Bashkiak Durrës, humbi konsistencen e afateve ligjore te funksionimit te tij gjate periudhes qe mbuloi ky monitorim. Neni 38 i ligjit 8652, "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore".parashikon shpërndarjen e parakohshme të Keshillit me VKM në rastet kur ai: a) nuk mblidhet për një periudhë të vazhdueshme tremujore; b) nuk arrin të marrë vendim për miratimin e buxhetit brenda tre muajve nga data e përcaktuar në nenin 19 të këtij ligji; c) kryen shkelje të rënda të Kushtetutës ose ligjeve.

Konkretilisht, Këshilli Bashkiak Durrës, për shkak të mos-veprimit "rrwshkiti" nw kushtet e parashikuara nga germat "a" dhe "b" të paragrafit 1 të këtij neni.

Po ashtu, në datë 12 Korrik 2013, kohe ne te cilen u mbyll ky monitorim, u mbushen gjithashtu plot 6 muaj nga hera e fundit kur këshilltarët kanë marrë pjesë në një mbledhje të këshillit (mbledhja e fundit ka qenë në dt 11 Janar 2013). Neni 27 i ligjit 8652, në pikën katër të tij, germa "e" përcaktton shprehimi si: Mandati i këshilltarit, mbaron para afatit, me propozim të komisionit të mandateve kur: e) nuk merr në mbledhjet e këshillit për një periudhë 6 mujore.

## → VI. REKOMANDIM PARESOR:

### **INFOÇIP rekandon sa më poshte vijon:**

1. Njohjen zyrtare nga autoritet eprore të vetë-shkrirjes së Këshillit Bashkiak (shpërndarja nga organi kompetent), për shkak të mos-ushtrimit të funksioneve për periudha përtëj afateve ligjore.
2. Thirrjen e zgjedhjeve të reja për Këshilli Bashkiak, Durrës në një kohë sa më të shpejtë të mundshme, në përputhje me Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqiperise.
3. Në periudhën nga data e zgjedhjeve e deri në konstituimin e këshillit të ri, këshilli i vet-shpërndarë të vijojë ushtrimin e funksioneve të kufizuara dhe të bëjë vendimarrje vetëm në raste emergjente, sic parashikon neni 31/6 e ligjit 8652.

## → II. PROBLEMI I IDENTIFIKUAR

Sic rezulton nga të dhënat e monitorimit, anashkalimi i procedurës që përcakton neni 31 pika 1 e **ligjit 8562, të ndryshuar**, për votimin e fshehtë të vendimeve me karakter individual, në rastin e Durrësit nuk rezulton se diktohet nga infrastruktura e munguar në sallén ku zhvillohen mbledhjet e Këshillit Bashkiak. Kjo është një sallë moderne, me infrastrukturë elektronike votimi.

Një arsy që mund të shpjegojë se përsë Këshilli Bashkiak në Durrës miraton përgjithësisht me votim të hapur vendimet më karakter individual, mund të ishte ndoshta njohja e paktë e dispozitave të **ligjit 8562, të ndryshuar** nga vetë këshilltarët. Në fakt, kjo do të kishte qenë një mosnjohje e justifikuar e ligjit "*ignorantia juris*", po të mbahet parasysh se nuk ka asnjë manual apo rregullore që të interpretojë dhe/apo caktojë kritere se çfarë dhe si dallohet një vendim individual nga një vendim normativ në kuadër të vendimarrjes së këshillave bashkiakë.

## → II. REKOMANDIM:

Duke prezumuar që niveli i ulët i zbatimit të dispozitave ligjore mund të vijë nga mos-njohja e mirë e vetë ligjit, një fushatë edukimi dhe ndërgjegjësimi ligjor, ku target kryesor janë këshilltarët, sekretarët e këshillave bashkiakë por edhe aktorët e tjera të interesuar, nevojitet të organizohet në kuadër të ndërhyrjeve në një nivel vendor. Synimi kryesor është rritja e cilësisë dhe ligjshmërisë së procesit vendimarrës përmes krijimit të mundësive reale që ata të informohen mbi detyrimet ligjore të Këshillit në procesin vendimarrës, sidomos sa i takon vendimarrjes me së hapur dhe me pjesëmarrje, por edhe lidhur me pubikimin e vendimeve të tyre (nenet 33, 34 dhe 35).

Po ashtu, INFOÇIP rekandon ngritjen e kapaciteteve kontrolluese që Prefektët dhe administra-ta e tyre ushtrojnë mbi ligjshmërinë e vendimarjes së këshillave bashkiakë.

### ► III. PROBLEMI I IDENTIFIKUAR

Duhet theksuar se këshillat bashkiake në Shqipëri, nuk kanë një administratë të posaçme, e cila do të kujdesej për aspektet teknike të procesit vendimarrës. E gjithë barra për administrimin e procesit vendimarrës bie mbi një person të vetëm, që në këtë rast është Sekretari i Këshillit Bashkiak, i cili jo domosdoshmërisht ka një formim (apo trajnim) profesional juridik.

Kjo është një mangësi e cila ka komprometuar cilësinë procedurale të procesit vendimarrës në nivel lokal, siç e indikojnë edhe gjetjet e këtij Raporti. Mungesa e votimit të fshehtë rrezikon "infektimin" e procesit nga "influenca" partiake. Kjo do të shkonte ndesh me interesin qytetar, për të cilin edhe vetë këshilltarët janë betuar solemnisht se do advokjnë (dhe jo interesat partiake).

### ► III. REKOMANDIM:

Prania e një personeli të kualifikuar me formim profesional juridik që do të ndihmonte këshilltarët të respektonin aspekte procedurale të ligjislacionit për qeverisjen vendore (si psh. votimi i fshehtë, votimi me shumicë të cilësuar, etj), të cilat janë tashmë një problem që duhet adresuar për zgjidhje me urgjencë. Kjo mund të adresohej përmes amendimeve në **ligjin 8652, të ndryshuar**, ose përmes programeve të mbështetjes me burime njerëzore të kualifikuara, që mund të financohen nga donatorë të ndryshëm. Këto programe mund të pilotohen fillimisht në disa bashki kryesore, me synim implementimin e një tradite ligjshmërie. Këto programe, përvèçse do të ndihmonin realisht në stabilizim e një traditë të re ligjshmërie në vendimarrjen lokale.

### ► IV. PROBLEMI I IDENTIFIKUAR

Në kuadër të rekomandimeve, INFOÇIP konsideron se shpërndarja në dy nene, konkretisht në nenin 33/6 dhe 35/3, e modaliteve që janë të domosdoshme për shpalljen dhe hyrjen në fuqi të një vendimi (*koha, vendi*), është një pakujdesi teknike e ligjvënësit, e cila, sikurse provohet edhe nga gjetjet, nuk i ka shërbyer mirë implementimit korrekt të tyre.

### ► IV. REKOMANDIM:

INFOÇIP rekordon që fjalia e parë e neni 35/3 "Aktet e këshillit afishohen, në vende publike të caktuara nga këshilli, brenda territorit të komunës ose bashkisë dhe, sipas mundësive, këshilli cakton edhe formë të tjera të publikimit të tyre", të shtohet si pikë e shtatë (7) në nenin 33. Madje, edhe vetë kjo fjali mund të riformulohej më mirë, si psh: *Aktet e sapo-shpalluara të këshillit, në mënyrë që të marrin fuqi juridike, afishohen<sup>1</sup>, në vende publike të caktuara nga këshilli, brenda territorit të komunës ose bashkisë dhe, sipas mundësive, këshilli cakton edhe formë të tjera të publikimit të tyre*".

Duhet theksuar se vetë shpallja si koncept implikon, për nga vetë përcaktimi, edhe subjektet të cilave ju drejtohen akti. Sa kohë që publiku mungon përgjithësisht nëpër mbledhjet e Këshillave, shpallja, në mënyrë që të prezumohet e kryer, duhet të implikojë domosdoshmërisht edhe një vend në të cilin akti shpallet përmes afishimit apo publikimit. Vetëm në këtë mënyrë, mund të bëhej fjalë për një proces të kompletuar të informimit proaktiv të publikut nga vetë institucioni. Në fund të fundit, është Këshilli Bashkiak ai që ka interesin kryesor që vendimet që nxjerr të njihen nga qytetarët, me qëllim që ato të zbatohen.

Bazuar po në këtë llogjikë, INFOÇIP vlerëson gjithashtu se referenca që **ligji 8653, i ndryshuar** bën në **ligjin 8653, "Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare"**, është e panevojshme kur bëhet fjalë për njohjen e vendimeve të Këshillit me kërkësë eksplikite nga vetë qytetarët.

## Sugjerim:

INFOÇIP vlerëson se dispozita 34/3 kontradikton me vetë frymës që mbart në të vërtetë ligji 8652, për një vendimarrje të hapur dhe me pjesëmarrje. Do të mjaftonte vetëm aplikimi korrekt i dispozitave për votimin e fshehtë (neni 33) për të superuar çdo "përkujdesje" që dispozita në fjalë mundohet t'i sigurojë procesit vendimarrës. INFOÇIP rekordon abrogimin e kësaj dispozite në kuadër të një amendimi të mundshëm në të ardhmen të ligjit 8652.

## ► V. PROBLEMI I IDENTIFIKUAR

Durrësi është një qytet me prurje të mëdha demografikë në 16 vitet e fundit. Ai ka pësuar edhe një shtrirje të konsiderueshme gjeografike për shkak të rritjes së numrit të popullatës së qytetit, e cila vijon edhe në ditët e sotme shtim të vazhdueshëm. Rrjedhimisht, edhe territori faktik që administron Bashkia Durrës është pothuajse dyfishuar krasuar me vitet '90, kohë para së cilës lëvizjet migratore (demografike) ishin mjaft të ulëta.

Njoftimi i aktiviteteve të këshillit bashkiak (të bashkisë në tërësi) tek një numër kaq i madh popullatës sështë tashmë një sfidë me natyrë logjistike. Ligji 8652, i ndryshuar parashikon se *Aktet e këshillit afishohen, në vende publike të caktuara nga këshilli, brenda territorit të komunës ose bashkisë*

Identifikime dhe më pas implementimi i sistemeve të reja për njoftimin e akteve të Këshillit tek sa më shumë qytetarë është në kushtet aktuale një domosdoshmëri jo vetëm ligjore, por edhe praktike. Në rast të kundërt, legjislativi i Bashkisë do të mbetet de-facto i distancuar nga qytetarët e vet teksa ushtron vendimarrjen në emër të tyre. Kurse këta të fundit, nuk do të janë *de-facto* qytetarë të mirë, sa kohë që, mos-njohja e vndimeve prej tyre mund të çojë në mos-zbatim të akteve.

## ► V. REKOMANDIM

Vendosja e disa ekraneve “LED” në disa vende me qarkullim të lartë publik, do të adresonte mjaft mirë për zgjidhje problemin në fjalë. Këto do të shërbenin që aktet e Këshillit të zbatoheshim më mirë dhe qytetarët të ishim më mirë të informuar për detyrimet e tyre në raport me pushtetin vendor. Kujtojmë këtu që transparenca me publikun është njëkohësisht edhe aleati më i mirë i çdo të zgjedhuri dhe funksionari publik gjatë ushtrimit të detyrave të tij.

Për mbledhje të rëndësishme të Keshillit, siç mund të janë ato për Taksat dhe Tarifat Vendore, Buxheti vjetor, etj, do të ishte e dobishme edhe shpërndarja e njoftimit përmes fletpalosjeve të cilat më pas tju shpërndahen qytetarëve nëpër sheshet apo rrugëkalimet kryesore të Durrësit. Ekranet “LED”, mund të shërbenin për të transmetuar live diskutimet në seance plenare, duke shmangur edhe që në sallë të ketë mbi-popullim me qytetarë të interesuar.

## ► V. PROBLEMI I IDENTIFIKUAR

Akomodimi i publikut të interesuar në sallat ku zhvillohen mbledhjet e Këshillit Bashkiak është një tjetër konstatim i Raportit. Problemet me natyrë infrastrukturore të sallave të mbledhjeve të Këshillave Bashkiak janë të përhapura në Shqipëri. Kjo mangësi është e justifikueshme për një pjesë të bashkive të cilat nuk kanë mundur dot të investojnë në ndërtimin e sallave bashëkohore për Këshillat Bashkiak (si p.sh në Korçë), por ngre pikëpyetje të rëndësishme për sallat e reja që janë ngritur në këto 7-8 vitet e fundit (Durrësi, Tirana, etj). Këto të fundit kanë vështirësi, për të mos thënë pamundësi materiale për të akomoduar publik dhe apo gazetarë që kanë dëshirë të ndjekin punimet në seancë plenare.

Një pjesë e ketyre sallave të reja janë ngritur edhe me kontributin e donatorëve të rëndësishmëm, që punojnë në Shqipëri prej vitesh për të promovuar të drejtën e pjesëmarrjes së qytetarëve në vendimarrje. Është e pashpjegueshme, madje e kritikueshme që, në momentin kur këto parime të rëndësishme duhet të materializoheshin në produkte konkrete, qytetarët nuk kanë qenë pjesë e ekuacionit që zgjidhej. Kjo, përvèçse pushtetin vendor, ngarkon me përgjegjësi edhe vetë komunitetin donator që kanë financuar ndërtimin e *parlamenteve të qyteteve* që, përfat të keq, nuk mundësojnë efektivisht pjesëmarrjen direkte të publikut.

## ► V. REKOMANDIM:

Për të adresuar problemi, INFOCIP rekomandon që, në kuadër të amendimeve të mundshme të *ligjit 8652, të ndryshuar*, që pikës 1 të nenit 34, t'i shtohet edhe një fjali e tretë, në të cilën të përcaktohet në mënyrë eksplikite se: “*Këshilli ka detyrim të garantojë infrastrukturën e nevojshme akomoduese për qytetarët e interesuar të ndjekin në sallë mbledhjet që ai zhvillon*”.

Sa i takon rastit të Durrësit, një investim minimal (tre rreshta me nga 7 apo 8 karike) do të mund të restauronte dimension akomodues të sallës së mbledhjeve të Këshillit Bashkiak, duke i mundësuar më mirë publikut ndjekjen e tyre.

Sa i takon donatorëve të ndryshëm, projektet e finançuara prej tyre në drejtim të ngritjes së infrastrukturës së sallave të këshillave bashkiakë / komunalë, është mirë të vlerësohen që në fazën e projekteve sa i takon kapacitetetëve aksesuese për publikun e interesuar që ndjek mbledhjet në sallë. Do të ishte një demagogji që, nga njëra anë të synohej pjesëmarrja e publikut në vendimarrjen vendore, dhe nga ana tjetër, sallat e reja ku Këshillat zhvillojnë aktivitet të mos kenë fare kapacitete akomodues për ta.

# METODOLOGJIA

## VLERESIMI I AKTIVITETIT VENDIMARRES

Nenet 33, 34 dhe 35 të ligjit 8652 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore", i ndryshuar, janë mishërimi praktik i lidhjes organike që garanton një proces vendimarës transparent dhe të hapur ndaj publikut. Zbatimi rigoroz i këtyre neneve është kusht juridik për të patur një vendimarrje transparente dhe të hapur ndaj publikut. Rrjedhimisht, matja e nivelit të implementimit të këtyre 3 neneve prodhon automatikisht indikatorë të drejpërdrejtë për vlerësimin objektiv të nivelit të transparencës nga vendimarrësit vendorë.

Zhvillimi i një metode për matjen e nivelit të zbatimit të këtyre tre neneve "të transparencës" dhe implementimi në praktikë i saj ka qenë një ndër objektivat kryesorë të këtij projekti. Kjo metodë e re monitorimi dhe vlerësimi u mor përsipër të zhvillohej nga INFOÇIP, në kuadër të një projekti integral i cili u implementua në dy bashki kryesore, konkretisht në Durrës dhe në Korçë. Modeli metodologjik është i tipit "**Monitorim përmes Pjesëmarrjes**", ose shkurt **MP**.

Mjeti kryesor metodologjik qe u zhvilluar nga ÇIP u emërtuar **PROAKTIV** (akronim i modifikuar për: *Protokoll i Vleresimit te Transparencës Vendimarrëse në Këshillin Bashkiak përmes Pjesëmarrjes Aktive*). Ky protokoll është *sui-generis*, që do të thotë se është "qepur pas trupit" të legjislacionit përkatës në fuqi në Republikën e Shqipërisë, në rastin konkret ligji 8652 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore", i ndryshuar. Në vija të përgjithshme, qasja PRO AKTIV ndërthur në një bllok të vetëm **monitorimin e ligjshmërisë së procesit vendimarrës të Këshillit Bashkiak përmes pjesëmarrjes dhe raportimit aktiv qytetar**.

## PËRSHKRIMI I DETAJUAR I PROAKTIV

Një grup qytetarësh nga shtresa, profesione dhe grupmosha të ndryshme, u përzgjodhëm dhe u trajnuan nga INFOÇIP për përdorimin autonom të disa prej hallkave të PROAKTIV. Përveç ndjekjes në sallë të çdo mbledhjeje të Këshillit Bashkiak për të testuar kështu konkretisht garantimin e të drejtës së publikut pjesëmarrje, ata do të mblidh-

nin të dhëna edhe për disa hallka të procesit vendimarës që normohen nga dispozitat e shperndare ne nenet 33, 34 dhe 35 të ligjit 8652 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore", i ndryshuar. Është e qartë se në këto kushte, procesi monitorues nuk limitohej brenda sallës dhe kohës në të cilën zhvilloheshin mbledhjet e Këshillit Bashkiak. Përkundrazi, një pjesë e rëndësishme e këtij procesi zhvillohej para apo pas përfundimit të këtyre mbledhjeve, (në kohën që projekt-aktete duhet t'i nënshtroheshin konsultimit me komunitetin para se ato të kalonin në votim, apo edhe kur vendimet tashmë të marra duhej të shpalleshin përmes publikimit dhe të hynin në fuqi).

Një raporti i hartuar pas përfundimit të çdo mbledhjeje të Këshillit Bashkiak, i dërgohej INFOÇIP për vlerësimë të mëtejshme. Raporti, përmes një strukture të përcaktuar, synonte mbledhjen e të dhënavë si: *Pjesëmarrja e Këshilltarëve bashkiakë në seancat e votimit, Vendimet e shqyrtuara dhe të miratuara, Rezultati i votimit, Axhenda e paralajmëruar e mbledhjes së Këshilit Bashkiak dhe modifikimet e saj në seancë plenare, etj.*

Të dhënat e këtij raporti riorganizoheshin përbledhatai edhe në formatin e një lajmi gazetaresk, i cili më pas publikohet *on-line*, në faqen zyrtare të Qendrës INFOÇIP, [www.infocip.org](http://www.infocip.org), tashme e linkuar ne faqen zyrtare te Bashkise Durrës. Ky report në stil gazetaresk i shërbente dy qëllimeve: Së pari ai ofronte një mundësi të paravarur informimi për cilindo qytetar, përdorues interneti, përfshirë edhe vetë administratën e bashkisë për të ndjekur në kohë reale aktivitetin e këshillit bashkik në këndvështrimin e një procesi te monitoruar nga shoqëria civile (ZTQ, Durrës).

Së dyti, ky lloj raportimi i shërben edhe promovimit të një kulture raportimi meditik *on-line* nga vetë qytetarët e përfshirë në nisma vendore monitoruese. Kjo kulturë e re shkon në një hap me prezantimin e mënyrave novatore për rritje të transparencës përmes *neë media* apo mjeteve të reja teknologjike që sot gjithmonë e më shumë janë në dispozicion të operatorëve të shoqërisë civile (shiko [www.infocip.org](http://www.infocip.org) ).

Po ashtu, për të garantuar vlerësimin sa më të

detajuar dhe objektiv nga ekspertët e INFOÇIP në Tiranë, të gjitha mbledhjet e Këshillit Bashkiak, të zhvilluara në periudhën kohore të mbuluar nga ky projekt, dokumentohen në audio-video. Ky dokumentim rigoroz është shumë i rëndësishëm në vlerësimin përfundimtar të modaliteteve ligjore të vendimarrjes ndërmarrë nga INFOÇIP, konkretisht, sa i takon përcaktimit të nivelit të implementimit të dispozitave ligjore që janë objekt monitorimi në kuadër të këtij projekti, konkretisht nenet 33, 34 dhe 35 të ligjit 8652 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore", i ndryshuar.

Bazuar mbi të dhënat e grumbulluara përmes PROAKTIV, ekipi i ekspertëve të INFOÇIP në Tiranë, pas një përpunimi rigoroz të tyre, ka vlerëuar hap pas hapi të gjitha dispozitat që përbajnë nenet 33, 34 dhe 35.

Në kuadër të kësaj metode, ***mesatarja e zbatueshmërisë*** së dy neneve 34 dhe 35 të marra së bashku indikon nivelin e Transparencës në Vendimaren Lokale, pasi dispozitat që përbajnjë këta dy nene, nëse zbatohen rigorozisht garantojnë pjesëmarrjen e plublikut në një proces të hapur **para, gjatë dhe pas vendimarrjes** së këshillit bashkiak.

Krashimi i mesatares së zbatueshmërisë së këtyre dy neve (34 & 35) para fillimit të projektit dhe në përfundim të tij (pas 12 muajsh, çka korrespondon me fazën e parë të implementimit), indikon apo pëershkruan edhe përmirësimin e nivelit të transparencës (hapje + vendimarrje e konsultuar me publikun + informim proaktiv) të gjeneruar si rezultat i ndërhyrjes përmes projektit. Dy vlerat e krashuara (në fillim dhe në fund të projektit), nëse diferencohen mes tyre teksa janë të vendosura në një shkallë përqindjeje, prodhojnë një indikator të posaçëm, të quajtur Indikatori i Rritjes së Transparencës (IRT). Ky indikator përdoret për të vlerëuar njëkohësisht rritjen e zbatueshmërisë së dy neneve 34 dhe 35 të marra së bashku si edhe impaktin e gjeneruar nga snergjia mes operatorit të shoqërisë civile (në rastin konkret të INFOÇIP dhe degës së saj lokale në Durrës, ZTQ) dhe Këshillit Bashkiak (në rastin konkret KB Durrës).

Përmes parashtrimeve të detajuar ligjore, të cilat bëhen për herë të parë në monitorime të këtij tipi, gjetjet fitojnë një përmasë të dukshme objektiviteti. Vizualizimi i të dhënave për secilën dispozitë, është pjesë substanciale e metodologjisë së zhvilluar nga INFOÇIP. Sikurse është bërë e ditur edhe në kaptujt më sipër, metoda në këtë rast mban parasysh premisën se **ligji 8652, i ndryshuar** ka elementë normues të mjaftueshëm përmes zbatimit të të cilave të mund të garantohet një nivel i kënaqshëm

i transparencës vendimarrëse. Matja e zbatueshmërisë së dispozitave në fjalë është një mënyrë objektive e vlerësimit të dyfishtë të nivelit të transparencës vendimarrëse në nivel vendor si dhe të nivelit të zbatimit të vetë ligjit të tyre organik nga organet vendimarrëse në qeverisjen vendore.

### VLERËSIMI I AFATEVE FUNKSIONALE

**Ligji 8652, datë 31.7.2000** "Për Organizimin dhe Funksionimin e Qeverisjes Vendore", i ndryshuar, rregullon me kujdes aktivitetin e këshillave bashkiakë përmes caktimit të afateve funksionale. Aplikimi i këtyre afateve fillon që në momentin e konstituimit të këshillave dhe vazhdon përgjatë gjithë kohës së ushtrimit të aktivitetit të tyre vendimarrës.

Ndër afatet më të rëndësishme që mat dhe vlerëson ky monitorim, janë periodiciteti i zhvillimit të mbledhjeve dhe miratimi i buxhetit vjetor. Mos-respektimi i këtyre afateve mund të çojë deri në shkrirjen e keshillave bashkiakë.

Neni 31 "Funksioni i këshillit komunal ose bashkiak" bën përcaktimet e rëndësishme sa i takon afateve funksionale të këshillit. Kështu, mbledhjet e radhës të këshillit duhet të zhvillohen si jo më pak se një herë në muaj (neni 31 pika 2). Thirrja për mbledhjen e këshillit bëhet nga kryetari i këshillit dhe njoftimi për mbledhjen bëhet, si rregull, jo më pak se 5 ditë para datës së zhvillimit të saj (neni 31, pika 4). Kur këshilli nuk mblidhet për shkak të mungesës së anëtarëve të tij gjatë tre muajve, duke filluar nga data e mbledhjes së fundit të tij, këshilli quhet i vetëshpérndarë. Vetëshpérndarja pasohet me zgjedhje të reja për këshillin përkatës dhe sekretari i këshillit komunal ose bashkiak, brenda 10 ditëve nga përfundimi i afatit 3-mujor, njofton prefektin (neni 31, pika 8).

Ligji 8652 ka gjithashtu dhe një nen të posaçëm "Për shpérndarjen e parakohshme të Këshillit". Ky është nen 38, i cili parashikon qartë tre raste kur këshilli shpérndahet para kohe, konkretisht: 1) kur nuk mbilidhet për tre muaj rrjesht, 2) kur nuk miraton buxhet dhe 3) kur bën shkelje të rënda të ligjit dhe Kushtetutës.

Sic shihet, vet-shpérndarja e Këshillit, nëse qëndron tre muaj pa aktivitet, është e parashikuar dy herë në dy nene të ndryshme (neni 31, pika 8 dhe nen 38, pika 1).

Metoda konsiston ne ballfaqimin post-factum te aktivitetit real dhe funksionimit të këshillit bashkiak me përcaktimet formale që bën ligji 8652, i ndryshuar. Kontrastimi i realitetit me përcaktimet ligjore jep rezultate solide të pakundërsueshme. Këto afate ligjore monitorohen për herë të parë nga një operator i specializuar i shoqërisë civile ne Shqiperi.

